



ARGUMENTET LOGJIKE QË TREGOJNË SE ZOTI ËSHTË NJË I VETËM E I PASHOQ SI DHE ASPEKTET E PËRSOSMËRISË SË TIJ

Shejh Abdurrahman Es Seadij



ARGUMENTET LOGJIKE QË
TREGOJNË SE ZOTI ËSHTË NJË I
VETËM E I PASHOQ SI DHE
ASPEKTET E PËRSOSMËRISË SË TIJ

Shejh Abdurrahman Es Sadij



thebaat.com

BOTIMI I PARË
1444h-2022g



Titulli origjinal: البراهين العقلية على وحدانية الرب ووجوه كماله

Titulli në shqip: Argumentet logjike që tregojnë se Zoti është Një i Vetëm e i Pashoq si dhe aspektet e përsosmërisë së Tij

Autori: Shejh Abdurrahman Es Seadij

Përkthyesi: Orgest Beja

Botuesi: Thebaat.com

Website: www.thebaat.com

©Të gjithë të drejtat janë të përkthyesit





HYRJE

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdet i takojnë vetëm Allahut, lavdërimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, kjo është një ligjëratë madhështore e cila përmban vërejtje të qartë rreth argumenteve logjike që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq si dhe aspektet e përsosmërisë së Tij. Dije se kjo çështje është çështja më madhore në mënyrë kategorike, më e obligueshmja, më e dobishmja, më e qarta dhe për këtë çështje janë në unanimitet të gjithë Librat e zbritur prej Allahut për të Dërguarit e tij si dhe të gjithë të Dërguarit janë në unanimitet rreth saj. Ajo është çështja më e rendësishme në të cilën të Dërguarit kanë thërritur popujt e tyre. Çdo i Dërguar i thonte popullit të tij:

(أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ) [الأعراف: 59]

“Adhuroni Allahun! Nuk keni Ilah (të adhuruar) tjetër veç Atij” [Surja El-Earaf 59]

dhe duke i përmendur popujve të tyre Emrat e Zotit dhe Cilësitë e Tij, mirësitë, begatitë e të mirat e Tij mbi ta nëpërmjet të cilave mund ta njohin Zotin e tyre, ti nënshtrohen Atij dhe ta adhurojnë Atë.

Kurani Madhështor prej fillimit të tij e deri në fund e sqaron këtë çështje dhe përmend argumente të shumëllojshme për të, i sjell ajetet e tij për të, si dhe Suneti gjithashtu.



Nuk është qëllimi në këtë ligjërim përmendja e argumenteve shariatike¹ rreth saj, sepse në Kuran dhe Sunnet² ka argumente dhe prova rreth saj aq sa nuk numërohen e nuk mund të mbulohet plotësisht çdo pjesë e saj dhe ajo është shumë e qartë të cilën e dinë intelektualët dhe njerëzit e thjeshtë, e disa prej këtyre argumenteve janë të mjaftueshme rreth qëllimit. Porse në këtë ligjërim duam të tregojmë shkurtimisht për argumentet logjike në të cilat janë pjesëmarrës në njohjen dhe pranimin e tyre të gjithë të mençurit prej njerëzve, të cilat nuk i mohon ato vetëm se çdo kryeneç mendjemadh, kundërshtues i logjikës dhe fesë. Kjo temë është shumë e qartë dhe e dukshme, aq sa për të pasur nevojë për të përmendur argumentet e saj, porse sa herë që besimtari i njeh argumentet rreth saj i forcohet atij besimi, i shtohet atij bindja dhe e falenderon Allahun rreth kësaj mirësie e cila është mirësia e më e madhe dhe më madhështorja. Prandaj dhe të dërguarit i kanë thënë popujve të tyre:

[أَفِي اللَّهِ شَكٌّ] (إبراهيم: 10)

“A ka dyshim për Allahun?” [Surja Ibrahim 10]

I pyetën ata me një pyetje pohuese sepse në zemrat e të gjithë të mençurve është e vendosur njohja e tyre për Zotërimin e Tij në krijim dhe adhurim.

¹ Shënim I perkthyesit: “Sheriat” do të thotë: Legjislacioni Islam

² Shënim I perkthyesit: “Sunnet” do të thotë: Çdo fjalë apo vepër apo pohim nga Profeti Muhamed ﷺ.



Pra themi dhe prej Allahut vjen sukcesi:

Krijimi i gjërave ka tre kategori logjike

Dije Allahu të mëshiroftë se nëse ti do vrojtosh në botën qiellore dhe atë tokësore dhe çka është vendosur në të prej krijesave të shumëllojshme dhe prej ndodhive të përsëritura në çdo kohë dhe pastaj medito me një meditim të saktë, do të kuptosh se çështjet mund të ndahen në tre lloje sipas logjikës:

E para: që gjithë këto krijesa dhe këto ndodhi të ekzistojnë nga vetja e tyre pa pasur ndonjë shpikës dhe krijues, por kjo është diçka e pamundur, dhe detyrimisht logjika është e detyruar ta mohojë patjetër këtë mendim të kotë, sepse çdokush që ka logjikë e kupton se nuk ka mundësi që të ekzistojë diçka pa pasur dikë që ta sjelli në ekzistencë apo ndonjë shpikës të saj.

E dyta: që këto krijesa të kenë krijuar veten e tyre, por kjo është e pamundur, detyrimisht logjika e mohon patjetër kotësinë e saj dhe nuk e pranon, sepse çdokush që ka pak logjikë e kupton se diçkaja nuk mund ta krijojë veten e saj, ashtu siç ajo nuk krijohet dot pa pasur ndonjë krijues të saj, e nëse u kuptua kotësia e këtyre dy kategorive nga logjika dhe natyrshmëria e pastër, atëherë rrjedh kategoria:

E tretë: E ajo është se këto krijesa dhe këto fenomene kanë një Krijues që i ka krijuar ato, e shpikës që i ka shpikur ato dhe Ai është Allahu Zoti Madhështor, Krijuesi



i çdo gjëje, Ai i Cili ka në kontroll çdo gjë, Mbikëqyrësi i të gjitha çështjeve.

Për këtë Allahu e ka vënë dukje këtë kategori logjike të qartë, për çdo të logjikshëm duke thënë:

﴿أَمْ خُلِقُوا مِنْ غَيْرِ شَيْءٍ أَمْ هُمْ الْخَالِقُونَ﴾ [الطور: 35-36]
﴿وَالْأَرْضَ بَلَّ لَا يُوقِنُونَ﴾ [الطور: 35-36]

“A u krijuan ata nga asgjë, apo ata vetë qenë krijuesit? Apo mos i krijuan ata qiejt dhe tokën? Por ata nuk kanë aspak besim të qëndrueshëm” [Surja Et-Tur 35-36]

Pra krijesa patjetër që ka nevojë për një Krijues ta krijojë, ashtu siç edhe gjurma që të ekzistojë patjetër duhet ta lerë dikush, ashtu siç edhe shpikja që të jetë në ekzistencë patjetër që ka nevojë për shpikësin e saj, ashtu siç edhe qenia patjetër që ka nevojë për krijuesin e saj, ashtu siç edhe gjëja e prodhuar patjetër që ka nevojë për prodhuesin e saj ashtu siç edhe veprimi patjetër që duhet të ketë një veprues. Këto janë çështje logjike mëse të qarta, ku pjesëmarrës në njohjen e tyre janë që të gjithë të logjikshmit, e ajo (njohja e ekzistencës së Allahut) është nga çështjet logjike më të mëdha, ndërsa ai i cili është skeptik ose dyshon në vërtetësinë e saj atëherë ka dëshmuar për çrregullimin e tij mendor si dhe humbjen e tij.



PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “TË MENDUARIT NË KRIJIMIN E NJERIUT DHE UNIVERSEVE”

-Mendo në veten tënde- Allahu të mëshiroftë-, si dhe shiko fillesën e krijimit tënd, u krijove nga një pikë e ngjizur (nga bashkimi i vezoreve femërore dhe atyre mashkullore), pastaj një copë gjaku e mpiksuar, pastaj në një copë mishi derisa u bëre njeri i plotë, i plotësuar me gjymtyrët e jashtme dhe të brendshme. A nuk të detyron ty ky vështrim dhe të drejton për ta pranuar Zotin e Plotfuqishëm për çdo gjë, Dija e të Cilit ka përfshirë çdo gjë, i Urti në çdo gjë që ka krijuar dhe shpikur?

Sikur të gjitha krijesat të bashkoheshin për ta bërë këtë pikë të ngjizur- të cilën Allahu e bëri fillesën tënde- të kalonte në këto faza të ndryshme, pastaj ta ruanin atë në këtë vend të sigurt (mitër), pastaj t'i bënin asaj gjymtyrë të jashtme dhe forca të brendshme, pastaj ti jepnin dëgjim, shikim dhe logjikë, pastaj ta zhvillojnë këtë krijim të çuditshëm dhe ta sistemojnë në këtë strukturë të organizuar dhe ti rendisin këto gjymtyrë në këtë renditje të përkryer, në mënyrë që çdo gjymtyrë të jetë në vendin e saj të përcaktuar për të, pra nëse ata do bashkoheshin për ta bërë këtë gjë, a është e mundur në njohuritë e tyre dhe a është e mundur në fuqitë dhe mundësitë e tyre të arrijnë ta bëjnë këtë gjë?

E pra ky vështrim i drejtë të çon ty në njohjen e Fuqisë së Allahut, Madhësisë së Tij dhe se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq, në nënshtrimin ndaj tij, në besimin tek Librat



e Tij, në të Dërguarit e Tij, në njohjen e Tij si dhe në të besuarit në Ditën e Fundit.

Medito se si i ruan Allahu qiejt dhe tokën dhe çka ka në to prej botëve të cilat nuk i di askush tjetër përveç Tij, medito në vazhdimësinë e jetës së tyre dhe në furnizimin e tyre me çdo gjë që ato kanë nevojë për të qenë në jetë, duke e bërë këtë nëpërmjet shkaqeve të llojllojshme e me sisteme nga më të çuditshmet, a nuk të tregon kjo ty për përsosmërinë e Zotit, për Zotërimin e tij në krijim dhe adhurim, për Dijen Tij të Gjërë dhe për Urtësinë e Tij të Gjithanshme?

Dhe me të vërtetë Allahu e ka tërhequr vëmendjen rreth këtij argumenti të qartë logjik në Fjalën e Tij:

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ تَقُومَ السَّمَاءُ وَالْأَرْضُ بِأَمْرِهِ ثُمَّ إِذَا دَعَاكُمْ دَعْوَةً مِّنَ الْأَرْضِ إِذَا أَنْتُمْ تَخْرُجُونَ﴾ [الروم: 25]

“Dhe nga Treguesit e Tij është se qielli dhe toka qëndrojnë me Urdhërin e Tij dhe më pas, kur Ai tju thërrasë me një thirrje kur, çtë shohësh. Ju do të dilni nga toka (nga varret tuaja për llogari e shpërblim)”
[Surja Er-Rrum 25]

﴿إِنَّ اللَّهَ يُمَسِّكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ أَنْ تَزُولَا وَلَئِن زَالَتَا إِنْ أَمْسَكَهُمَا مِنْ أَحَدٍ مِّن بَعْدِهِ إِنَّهُ كَانَ حَلِيمًا غَفُورًا﴾ [فاطر: 41]

“Sigurisht që Allahu shtrëngon qiejt dhe tokën që të mos shkëputen nga vendet e tyre dhe po të ishte se ata



do të shkëputeshin nga vendet e tyre, nuk ka asnjë që mund ti kapte pas Tij. Vërtet që Ai është gjithmonë më Durimtari, Falës i madh” [Surja El-Fatir 41]

Medito o vëlla në këtë univers të rumbullakët dhe çka ndodh prej saj në ndërrimin e natës dhe të ditës, në ndryshimin e stinëve dhe në përsosjen e sistemit të saj në dobi të robërve dhe të interesave të tyre, të cilat janë aq të shumta sa nuk mund të numërohen. E gjitha kjo a mos ndodhi rastësisht dhe në dakordësi pa patur asnjë shpikës dhe veprues?

Apo Ai i Cili e krijoi këtë dhe e rregulloi atë në këtë organizim të përkryer është Ai i cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar? Siç edhe ka tërhequr vëmëndjen rreth këtij fakti logjik në Fjalën e Tij:

{صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي أَتَّقَنَ كُلَّ شَيْءٍ} [النمل: 88]

“Vepër e Allahut i Cili përsosi çdo gjë” [Surja En-Neml 88]

Vështro -Allahu të udhëzoftë- në atë se Ai çdo gjëje i ka dhënë formën dhe llojin të cilës i përshtatet asaj, pastaj e udhëzoi çdo krijesë për tek dobitë, interesat dhe nevojat e saj për të cilat nuk bën dot pa to në vazhdimësinë e jetës së saj, madje edhe kafshët, të vegjëlit dhe të mëdhenjtë e tyre i ka frymëzuar dhe udhëzuar për çdo çështje në të cilën kanë dobi dhe u nevojitet për vazhdimësinë e ekzistencës së tyre, jua lehtësoi atyre rrizkun e ushqimin dhe i udhëzoi ato për t'i ngrenë.



Çdokush i cili vështron në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe përhapjen e saj tek të gjitha krijesat, si dhe frymëzimin e tyre me këtë lloj frymëzim të çuditshëm nëpërmjet të cilit udhëzohen krijesat për tek gjërat e tyre të dobishme, do e kuptojë përkujdesin e madh të Ndihmuesit (Allahut), dhe do e kuptojë se Ai është Zoti i çdo qenieje, Krijuesi i çdo krijese, Furnizuesi i çdo qenieje i Cili i mësoi krijesat dhe ju dha atyre mendje e aftësi nëpërmjet së cilës kuptojnë se çfarë ju bën dobi dhe si t'i largojnë të këqijat prej tyre, e pra kjo është argument logjik i qartë dhe i madh që tregon se Allahu është Një i Vetëm dhe i Pashoq si dhe për përsosmërinë e Tij. E Allahu ka treguar për këtë në fjalën e tij:

﴿قَالَ رَبُّنَا الَّذِي أَعْطَى كُلَّ شَيْءٍ حَلْقَهُ ثُمَّ هَدَى﴾ [طه: 50]

“Tha: Zoti ynë është Ai i Cili i dha çdo gjëje formën dhe llojin e vet dhe pastaj e udhëzoi drejt” [Surja Ta-Ha 50]

Pra a është në natyrën e kafshëve të llojllojshme ky udhëzim, e ky frymëzim, që të arrijnë vetë tek ato gjëra që ju bëjnë dobi dhe t'i sprapsin ato gjëra që janë të këqia për to? apo dhembshuria për të vegjëlit e tyre, përkujdesja e tyre për ta derisa ata të fillojnë të lëvizin dhe të pavarsohen?

A nuk është kjo dhembshuri dhe mëshirë e vendosur tek kafshët për të vegjëlit e tyre nga argumentet më të mëdhaja për Mëshirën e gjërë të Allahut, për Dijen dhe Urtësinë e Tij të Gjithanshme?



**PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË
ALLAHUT) ËSHTË: “MËSHIRA E
PËRGJITHSHME E ALLAHUT”**

-Pastaj vrojto-Allahu të mëshiroftë- për Mëshirën e gjërë të Allahut e cila ka mbushur të gjitha cepat e botës, e cila ka përfshirë çdo krijesë në çdo gjendje dhe në çdo kohë të saj.

Nga Mëshira e Tij i krijoi krijesat.

Nga Mëshira e Tij i mban në jetë dhe i ruan ato.

Nga Mëshira e Tij i furnizon me çdo gjë për të cilën ato kanë nevojë dhe e ka plotësuar e përsosur Mirësitë e Tij mbi ju të dukshme e të padukshme, pa të cilat anjë krijesë nuk mundet të bëjë pa to as sa një përpëlitje të syrit, e ato mirësi mbi të janë të llojllojshme nga çdo këndvështrim:

Mirësitë e të mësuarit çështjet e Fesë dhe të dunjasë.

Mirësitë e shëndetit për trupat në përgjithësi dhe për çdo gjymtyrë e forcë të trupit në veçanti.

Mirësitë e të pasurit fëmijë, familje dhe pasardhës.

Mirësitë e rrizkut të bollshëm.

Mirësitë e lëvrimin e tokave, të mbjellave dhe të korrave.

Mirësitë e të pasurit bagëti dhe e të pasurit mallra.

Mirësitë e Tij për të pasur vendbanime dhe ndërtesa.

Mirësitë në kënaqësi dhe në gëzime.



Mirësitë në të cilat gjenden tek ato afrimi i çdo gjëje të dobishme dhe largimi i çdo të keqeje.

Të gjitha këto janë argumenti më i madh tregues për Allahun Një të Vetëm e i Pashoq, të Zotit të tij (njeriut), Mirëbërësit të tij, dhe Dhuruesit të tij, dhe gjithashtu (janë argumenti më i madh) tregues për Bujarinë e Tij të Gjërë dhe për obligueshmërinë për ta falenderuar Atë, për tui nënshtruar Atij dhe që adhurimi të jetë i sinqertë vetëm për Të:

﴿أَفَمَن يَخْلُقُ كَمَن لَّا يَخْلُقُ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ﴾ [النحل: 17]

“A është njësoj atëherë Ai i Cili krijon me atë që sbën asgjë. A nuk do të përkujtoni atëherë (Begatitë e Allahut) e të vini mend?” [Surja En-Nehl 17]

﴿وَمَا بِكُمْ مِّن تَعَمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ ثُمَّ إِذَا مَسَّكُمُ الضُّرُّ فَإِلَيْهِ

تَجَعَّرُونَ﴾ [النحل: 53]

“Dhe gjithçka nga mirësitë dhe begatitë që keni janë nga Allahu. Pastaj kur ju godet fatkeqësi, Atij i drejtoheni me thirrje rënkuese për ndihmë” [Surja En-Nehl 53]



**PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË:
“TË VROJTUARIT NË GJËNDJET E NDRYSHME
TË HALLEXHINJVE”**

- Pastaj vrojto gjëndjet e ndryshme të nevojtarëve të cilët janë buzë shkatërrimit, duke përjetuar rreziqe dhe të cilët janë në atë gjëndje nga varfëria e madhe ose nga sëmundja e tyre e dhimbshme nga e cila vuajnë, si i detyrojnë hallet dhe i drejton nevoja e tyre e madhe për tek Zoti dhe i Adhuruari i tyre, duke e lutur dhe duke kërkuar me nevojë të madhe për Të dhe Ai iu përgjigjet lutjeve të tyre dhe ua largon brengat e tyre dhe ua heq hallet e tyre. A nuk është ky argumenti më i madh që tregon se Allahu është Një i Vetëm dhe nuk është ky argumenti më i madh për Dijen e Mëshirën Tij të madhe, për kujdesin e Tij delikat dhe se Ai është strehimi për të gjitha krijesat. Dhe këtë argument logjik e ka vënë në dukje Allahu në fjalën e Tij:

﴿أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ وَيَجْعَلُكُمْ خُلَفَاءَ الْأَرْضِ ۗ إِنَّهُ مَعَ اللَّهِ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ ﴿٦٦﴾ أَمَّنْ يَهْدِيكُمْ فِي ظُلُمَاتٍ الْأَبْرَارِ وَالْبَحْرِ وَمَنْ يُرْسِلُ الرِّيْحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ۗ إِنَّهُ مَعَ اللَّهِ تَعَالَى اللَّهُ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٦٧﴾﴾ [النمل: 62-63]

“A nuk është Ai (më i mirë se zotat tuaj) i Cili i përgjigjet të pikëlluarit kur ai i drejtohet Atij dhe i Cili e largon të keqen dhe u bën ju trashëgues të tokës brez pas brezi. A ka ndonjë zot tjetër me Allahun? Sa pak mendoni!” A nuk është Ai (më i mirë se zotat tuaj) i Cili



ju udhëzon ju në errësirën e tokës e të detit dhe i Cili dërgon erërat si lajmëtarë të përgëzimit duke paraprirë Mëshirën e Tij (shiu)? A ka ndonjë zot tjetër me Allahun? I Lartësuar në Madhështi qoftë Allahu mbi gjithçka që ata ia mveshin Atij si të barabartë!” [Surja En-Neml 62-63]

﴿لَيْنٌ أَنْجَيْنَا مِنْ هَذِهِ لَنُكُونَ مِنَ الشَّاكِرِينَ ﴿٢٢﴾ فَلَمَّا أَنْجَلْنَاهُمْ إِذَا هُمْ يَبْغُونَ فِي الْأَرْضِ بِغَيْرِ الْحَقِّ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّمَا بَغَيْتُمْ عَلَىٰ أَنْفُسِكُمْ مَتَاعَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا ثُمَّ إِلَيْنَا مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢٣﴾﴾ [يونس: 22-23]

“Nëse Ti (Allah) na shpëton ne nga kjo, me të vërtetë që ne do të jemi falenderues. Por kur Ai i shpëton ata, kur ja! Ata ngrenë krye (nuk i binden Allahut) në tokë me padrejtësinë më të madhe. O njerëz! Kryengritja juaj (mosbindja ndaj Allahut) është vetëm kundër vetes suaj, një kënaqësi e shpejtë e jetës së kësaj bote, pastaj (më në fund) tek Ne është kthimi juaj dhe Ne do t’ju njoftojmë gjithë ç’keni punuar” [Surja Junus 22-23]

Ky lloj i cili është –shpëtimi i hallexhinjve- e kanë dëshmuar të gjitha krijesat me sytë e tyre dhe kanë parë prej situatave të ndryshme aq sa nuk numërohen, kjo pra i detyron ata që ta njohin Allahun dhe se Ai është Një i vetëm e i Pashoq. Shiko në gjendjet e nevojtarëve kur ata i zënë sprovat dhe i shqetësojnë fatkeqësitë, se si i gjen zemrat e tyre të lidhura me Allahun dhe gjuhët e tyre duke



këmbëngulur në lutje, zemrat e tyre duke pritur me padurim që ta arrijnë atë, nuk mënjahen nga Allahu as djathtas as majtas, për shkak të njohjes së tyre të domosdoshme, se Ai është i vetmi Lagues i vështirësive, Laguesi i brengave, ska strehim për krijesat vetëm se tek Ai dhe ska mbështetje për ta vetëm se tek Ai?

Këto çështje janë të atilla sepse krijesat janë të krijuara për ta njohur ekzistencën e Zotit të tyre.

Dhe se Ai është Dobisjellësi dhe Dëmsjellësi.

Dhe gjithë sundimi i çdo gjëje është në dorën e Tij.

A mund të mohojë ndokush këtë (që përmendëm) përveç atij që i është prishur natyrshmëria e tij me besime të kota dhe qëllime të këqija?

Shiko në nevojën e madhe të krijesave për Zotin e tyre në çdo gjë.

Ata kanë nevojë për Të qoftë kur u krijuan ashtu dhe kur erdhën në ekzistencë.

Ata janë nevojtarë për Të qoftë për të mbijetuar, qoftë për jetesën dhe furnizimin e tyre.

Ata janë nevojtarë për Të për të marrë çdo përfitim që u sjell dobi atyre.

Ata janë nevojtarë për Të për të larguar çdo të keqe prej tyre.

Ata e lusin Atë me gjuhët dhe zemrat e tyre dhe Ai ua jep atë që ata kërkojnë, i ndihmon ata në të gjitha interesat e



tyre, nëse duan diçka nuk e duan vetëm se nga Ai, dhe nëse i zënë fatkeqësitë nuk i drejtohen askujt përveçse Atij.

Sa e sa ja ndreq gjërat të dërrmuarit nga hallet dhe ia lehtëson atij atë që kërkon.

Sa e ndihmon fatkeqin.

Dhe sa që kanë qënë pranë vdekjes i ka shpëtuar.

Pra nevoja e tyre për Të në të gjitha situatat është e qartë dhe (faktin) e panevojshmërinë së Tij për ta nuk e mohon vetëm se një mendjemadh mohues.

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: "PËRGJIGJA E ALLAHUT NDAJ LUTJEVE NË ÇDO KOHË"

Krijesat nuk i numërojnë dot se çfarë u jep atyre që luten, dhe i përgjigjet lutjes së atyre që luten, si të devotshmit dhe atij të keqit, si muslimanit dhe jobesimtarit. Arrijnë njerëzit shumë prej synimeve dhe nuk dinë të kenë bërë diçka shkak përveç lutjes, lakmisë së madhe në Mirësinë e Allahut dhe duke shpresuar në Mëshirën e Tij. Ky argument është i qartë në çdo kohë, nuk e mohon atë vetëm se një kryelartë femohues. E lusin Atë në çështjet e fesë së tyre dhe Ai i përgjigjet, e lusin Atë në çështjet e dunjasë së tyre dhe Ai i përgjigjet,



﴿فَإِذَا قَضَيْتُمْ مَنَسِكَكُمْ فَادْذُكُرُوا اللَّهَ كَذِكْرِكُمْ آبَاءَكُمْ أَوْ أَشَدَّ
ذِكْرًا ۗ فَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ
خَلْقٍ ۗ وَمِنْهُمْ مَّن يَقُولُ رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ
حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ۗ أُولَٰئِكَ لَهُمْ نَصِيبٌ مِّمَّا كَسَبُوا ۗ وَاللَّهُ سَرِيعُ
الْحِسَابِ﴾ [البقرة: 200-202]

“Por nga njerëzit ka disa që thonë: “Zoti ynë! Na jep nga Begatitë e Tua në këtë botë!” E për të këtyrët nuk ka më hise në Botën e Pastajme. Por prej tyre ka edhe që thonë: “Zoti ynë! Na jep në këtë botë çfarë është e mirë dhe në Botën Tjetër çfarë është e mirë dhe na ruaj nga ndëshkimi i Zjarrit! Për këta do të përcaktohet një pjesë për çfarë ata kanë fituar. Dhe Allahu është më i Shpejti në llogari” [Surja El-Bakareh 200 - 202]

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “ARGUMENTET QË KANË SJELLË PROFETËT”

Prej argumenteve për ekzistencën e Allahut dhe se Ai është Një i Vetëm, është dhe ajo çka Allahu ja jep profetëve prej mrekullive të jashtënormales, provave dhe argumenteve të pakontestueshme, me çka Ai i nderon ata në dunja, i bën ata triumfues (ndaj atyre që i mohojnë) e me një përfundimin të mirë, i poshtëron armiqtë e tyre si



dhe i dënon ata me lloje te ndryshme denimesh. Kjo e transmetuar dhe e ditur si në mesin e njerëzve intelektualë ashtu dhe në mesin e njerëzve të thjeshtë, të gjithë popujt, gjeneratat dhe brezat e kaluar i kanë përcjellë lajmet e tyre, aq sa janë bërë argumente më të mëdha se dielli dhe hëna, të gjitha ato janë argumente që tregojnë për zotërimin e Atij që i ka dërguar ata dhe veçimin e Tij në adhurim, Sundimit e Tij të madh, Fuqinë e Tij të plotë, rreth GjithëDijes dhe Urtësisë së Tij dhe këto argumente nuk i mohon vetëm së një arrogant kryelartë.

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “LIBRAT QIELLORË DHE SUNNETI PROFETIK E ÇKA PËRMBAJNË ATO PREJ NORMAVE DHE LIGJEVE”

Prej argumenteve me të mëdha që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq: Është ajo çfarë Ai i ka zbritur profetëve të Tij në përgjithësi, prej librave të shenjtë dhe legjislacioneve, dhe çfarë i ka zbritur Muhamedit ﷺ³ në veçanti, prej Librit të Madhërisëm (Kuranit), prej shariatit të plotë, e cila në të gjendet përmirësimi i të gjithë njerëzve, dhe ajo është baza me të cilën qëndron feja dhe dunjaja e tyre.

³ Shënim i perkthyesit: kjo shenjë ﷺ do të thotë sal-laLLahu alejhi ue selem (lëvdatat e shumta dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi profetin Muhamed)



Në të ka prova dhe argumente aq sa nuk mund ta shpjegojnë shpjeguesit dhe nuk mundën ta përshkruajnë përshkruesit, provat e saj janë të pranishme në çdo kohë, sfiduese për të gjitha krijesat, megjithë dallimin ndërmjet popujve dhe feve të tyre, dhe sigurisht është sqaruar paaftësia e tyre dhe iu është bërë e qartë:

﴿سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّىٰ يَدَّبَّيْنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ أَوْ
لَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿٥٦﴾ وَيَوْمَ نَبْعَثُ فِي كُلِّ أُمَّةٍ
شَهِيدًا عَلَيْهِمْ مِّنْ أَنْفُسِهِمْ وَجِئْنَا بِكَ شَهِيدًا عَلَىٰ هَؤُلَاءِ وَنَزَّلْنَا عَلَيْكَ
الْكِتَابَ تَبْيِينًا لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً وَبُشْرَىٰ لِلْمُسْلِمِينَ ﴿٥٧﴾﴾
[النحل: 89]

“Ne do t’u shfaqim atyre Shenjat Tona në gjithësi dhe në vetë veten e tyre, derisa t’u bëhet e qartë se ky (Kur’ani) është e vërteta” [Surja Fussilet 53] “Dhe Ne ta kemi zbritur ty Librin (Kur’anin) shpjegues të gjithçkaje si dhe udhëzues, mëshirë dhe përgëzues për Muslimanët” [Surja En-Nehl 89]

E kush shikon në atë që përmban Kurani i Madhërisëm prej lajmeve të vërteta dhe dispozitave të drejta, legjislacionit të përpiktë, te e mira përgjithshme, te afrimi i përfitimeve të dobive si në çështjet fetare dhe ato të dunjasë dhe largimin e të këqiave nga ato të dyja, në mirësinë e madhe dhe në udhezimin e saj, në drejtësinë absolute e të plotë të saj, pra detyrohet ta pranojë se ai



(Kurani) është zbritur nga më i Urti, Zotëruesi i të gjitha lavdërimeve, prej një Zoti që është më Bujari. Gjithashtu kush shikon në atë që ka ardhur i Dërguari ﷺ prej Sunnetit dhe kushtetutës së plotë e të përkryer dhe fesë e rrugës së drejtë në të gjitha aspektet e saj- atëherë themi se do detyrohet vetëm nga disa prej këtyre argumenteve- e jo më pastaj me të gjitha argumentet në tërësi- që ta pranojë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe se ai që e ka ligjësuar Sheriatin Islam është një Zot i Plotfuqishëm, i Urtë në Sheriatin dhe Fenë e Tij, ashtu siç është më i Urti në atë që ka krijuar dhe caktuar.

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “NATYRA E PASTËR E NJERIUT ËSHTË E DETYRUAR PËR TA NJOHUR ALLAHUN”

Prej argumenteve që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq është se: mendja dhe natyra e njeriut është e detyruar për ta njohur Krijuesin e saj, përsosjen e Fuqisë së Tij dhe ndikimin e Vullnetit të Tij, e kjo ndodh për shkak se krijesat janë në nevojë dhe të detyruara për të siguruar çdo gjë që ju bën dobi dhe të largojnë çdo gjë që ju bën dëm. Siç dihet nga çdo i logjikshëm se nevoja e shpirtrave për Krijuesin e tyre, për Zotin e tyre është më e madhe se çdo nevojë dhe domosdoshmëri tjetër, e ajo është e detyruar ta dijë se Ai është Krijuesi i saj, Pronari i saj i vetëm dhe i vetmi që e mban atë në jetë, Furnizuesi i saj i vetëm i cili i jep gjërat më të dobishme për të,



﴿فَظَرَّتْ اللَّهُ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللَّهِ ذَلِكَ الدِّينُ
الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ﴾ [الروم: 30]

“Natyrshtëria e pastër, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë!” [Surja Er-Rum 30]

dhe nuk del askush nga kjo natyrshmëri përveç atij që e kanë devijuar shejtanët dhe ja kanë ndryshuar atë, e ja kanë ndërruar me besime të kota, me imagjinata të humbura, me ide të ndyra dhe me teori të gabuara. Sikur ata ti kishin lënë vetëm, ata nuk do të prireshin drejt askujt tjetër përveç Zotit të tyre, ata do të ktheheshin vazhdimisht te Ai për të siguruar të mirat dhe larguar të këqiat nga vetet e tyre, do ktheheshin tek Ai duke e adhuruar atë, duke qënë të nënshtruar dhe të përlulur për Të.

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “SHPËRBLIMI I SHPEJTË PËR PUNËMIRËT DHE DËNIMI I SHPEJTË PËR PUNËKËQINJTË”

Prej argumenteve që tregojnë se Allahu i Lartësuar është Një i Vetëm e i Pashoq dhe prej argumenteve që tregojnë për Bujarinë e Tij është: nderimi që ju bën Allahu atyre të cilët mbajnë lidhjet farefisnore, atyre që ndihmojnë nevojtarët dhe hallexhinjtë, ia kthen atyre menjëherë atë që ata shpenzojnë dhe ia kompenson atyre nga Mirësia



dhe Bujaria e Tij dhe i hap atyre dyer dhe sebebe për shtimin e pasurisë si shkak i asaj vepre të mirë, e cila ka lënë efekt të mirë. Njerëzit të cilët meditojnë e dinë mirë se shkak i saj (shtimit të pasurisë) janë ato vepra të mira, mbajtja e lidhjeve farefisnore, bamirësia si dhe punë të mira të mëparshme. A nuk na tregon kjo se Allahu i vendos çdo shpirti në bazë të asaj që ai fiton? Dhe se ky përshpejtim i shpërblimit a nuk është shembull i shpërblimit në botën tjetër?

Llojet dhe individët e këtyre shkaqeve nuk mund të numërohen, njerëzit kanë parë prej saj çudira, si vërtetim i fjalës së Allahut:

﴿وَمَا أَنْفَقْتُمْ مِّنْ شَيْءٍ فَهُوَ يُخْلِفُهُ وَهُوَ خَيْرُ الرَّازِقِينَ﴾ [سبأ: 39]

“Dhe çfarëdo që ju të shpenzoni nga ndonjë gjë (për Hir të Allahut), Ai do tjua zëvendësojë atë” [Surja Sebe'e 39]

﴿لَئِن شَكَرْتُمْ لَأَزِيدَنَّكُمْ﴾ [إبراهيم: 7]

“Nëse falenderoni unë do tju jap akoma më shumë (prej Begative)” [Surja Ibrahim 7]

Gjithashtu është vërtetim i fjalës së të Dërguarit të Allahut: **“Kush dëshiron ti hapet rrizku, dhe ti shtohet jeta le të mbajë lidhjet farefisnore”**. (Buhari, Muslim)



Sa e sa mirësi i ka dhënë Allahu atij që ka bërë mirë, sa e sa ja ka zëvendësuar pasurinë atyre që kanë shpenzuar për mirë, sa e sa ja ka përmirësuar zemrat atyre të cilëve mbajnë lidhjet farefisnore duke ju frikësuar dënimit?

I ngjashëm me këtë argument janë dënimet që Allahu ia përshpejton shkelësve të kufijve, atyre që këpusin lidhjet farefisnore, zullumqarëve dhe kriminelëve në varësi të shkeljeve që kanë bërë, dënime të cilat i shohin njerëzit me sytë e tyre dhe e kuptojnë me bindje të plotë se këto shpërblime dhe këto dënime janë për shkak të shkeljeve që kanë bërë.

Kush mediton dhe i ka dëgjuar këto raste, shpërblimin dhe dënimin e Allahut të krijesat e Tij, e kupton lidhjen e saj me shkaqet e mira dhe të këqija, e mëson mirë se vetëm Allahu është i përsosur, se i gjithë Sundimi universal i takon Atij, se të gjithë adhurimin e meriton vetëm Ai, e mëson mirë drejtësinë e Tij absolute dhe Bujarinë e Tij të madhe, e aq më tepër për tu argumentuar me to për ekzistencën e Tij dhe obligueshmërinë e ekzistencës së Tij.

Çdo gjë e cila tregon për diçka rreth Cilësive të Tij, rreth Veprimeve të Tij, sigurisht që ajo përmban vertetueshmërinë e qenies së Tij dhe obligueshmërinë e ekzistencës së Tij.

Dhe gjithashtu e mëson mirë lidhjen e botës qiellore dhe tokësore me Të në ardhjen e tyre në ekzistencë, në mbajtjen e tyre në jetë, në ruajtjen dhe furnizimin e tyre me çdo gjë për të cilën kanë nevojë.



Kapitulli



“RRUGËT PËR NJOHJEN E ALLAHUT JANË TË GJËRA DHE TË PAKUFIZUARA”

Dije se rrugët për njohjen e Allahut janë jashtëzakonisht shumë të gjëra, e kjo sipas nevojave të krijesave dhe domosdoshmërive të tyre. Çdokush e shpreh nevojën e vet me shprehi të ndryshme qoftë tërësisht, qoftë pjesërisht, sipas nevojës që i lind dhe sipas çështjeve më të rëndësishme që ka.

Përndryshe, çdogjë që zemra e mendon, që sytë e shohin, që shqisat dhe ndjenjat e perceptojnë, çdo gjë e cila lëviz apo qëndron e palëvizshme, çdo kafshë apo objekt i pajetë, të gjitha këto janë prova, argumente dhe shenja që tregojnë se Allahu është Një i vetëm e i Pashoq.

(Në një poezi thuhet):

Në çdo gjë ka prova,

e cila tregon se Ai është Një i vetëm.

Porse aspektet individuale vijnë më shpejt në mendje, zemrat i kuptojnë ato më me detaje, arrihen prej tyre dobi të shpejta sepse ato janë të lehta dhe të thjeshta, kuptohen pa vështirësi, tani po përmendim disa shembuj dhe histori nga njerëzit në të shkuarën dhe të tashmen, çdokush kupton prej tyre ato që i përshtatet dhe lidhet me nivelin e të kuptuarit nga ai.



DISA SHEMBUJ DHE HISTORI PËR ARGUMENTIMIN RRETH ALLAHUT

Janë pyetur disa prej tyre: si e njohe Allahun?

(Thanë): bajga (e lënë në rrugë) tregon për ekzistencën e kafshës, gjurmët e këmbëve tregojnë se dikush ka ecur, qielli plot yje, toka me shumë lugina, detet plot me dallgë, a nuk tregon kjo për më të Butin, më Dashamirësin (ndaj robërve të Tij), për të Mirënjohurin për çdo gjë?!

U mblodh një grup ateistësh me disa Dijetarë, mendoj se ka qënë Ebu Hanifeh dhe i thanë: cili është argumenti për ekzistencën e Krijuesit?

Ai i tha atyre: më lini vetëm, sepse mendja ime tani është e angazhuar më një çështje të çuditshme!

I thanë: E cila është ajo?

Ai i tha: më kanë njoftuar se ne lumin e Tigrin është një anije e madhe e tejmbushur me lloje të ndryshme mallrash nga më të çuditshmet, ajo shkon dhe vjen pa pasur asnjë lundrues që ta lëvizë apo timonier që ta drejtojë.

Ata i thanë atij: Mos je gjë i marrë?

Ai i tha: E pse?

Ata u përgjigjën: A e beson një njeri i logjikshëm këtë?

Ndërsa ai i tha: e si e kanë besuar mendjet tuaja se kjo botë dhe gjithçka që ajo përmban prej specieve, llojeve dhe ngjarjeve nga më të çuditshmet, e ky univers që lëviz, e plot ngjarje që ndodhin ndodhin pa i shkaktuar dikush,



dhe çdo gjë që lëviz, lëviz pa pasur ndonjë që ti lëvizi ato, e kështu ata u kthyen të turpëruar.

Iu tha disave: Si e njohe Zotin tënd (se ekziston)?

Thanë: kur një burrë e fertilizon një femër, Allahu pastaj e zhvillon nga një lëng të ngjizur në një copë gjaku të mpiksuar, pastaj në një xhungë mishi e me rradhë deri në fund të formimit të procesit, derisa të formohet si njeri i plotë me gjymtyrët e jashtme dhe ato të brendshme, ka aftësinë e dëgjimit e me të dëgjon zërat, ka shikimin e me të shikon çdo gjë të dukshme, ka logjikën nëpërmjet së cilës udhëhiqet drejt gjërave të mira për të, ka dy duar për të goditur me to dhe për të punuar punë të imëta, ka dy këmbë me të cilat ecën me to dhe gjymtyrë të tjera të shumta të cilat janë krijuar për të sjellë dobi të tjera të njohura dhe ka gojë nëpërmjet së cilës futet ushqimi dhe hapësira të tjera në trup për të nxjerr jashtëqitjen dhe urinën që mund ta dëmtojnë (nëse qëndrojnë në të). Është strukturuar në këtë model të habitshëm që sikur të mblidheshin të gjithë njerëzimi për të krijuar një njeri të vetëm si ky krijim i përsosur dhe i mahnitshëm do dështonin njohuritë dhe mundësitë e tyre, e pra a nuk është kjo një provë dhe argument i qartë për ekzistencën e Krijuesit, për Madhësinë e Tij dhe se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq?

Them: Allahu e ka përmendur këtë lloj argumentimi në librin e Tij në forma të ndryshme!

Iu tha disave të tjerëve: si e njohët Zotin tuaj (se ekziston)?



Thanë: Duke e lënë vendosmërinë dhe synimet që kisha.

Kuptimi kësaj është: se robi është i patundur dhe i vendosur në shumë prej çështjeve të tij me siguri të prerë dhe pa ndonjë hezitim e pas kësaj e zhvlerëson synimin e tij dhe fillon e dobësohet derisa ta lërë fare për një çështje tjetër të cilën e shikon më të mirë për veten e tij.

Kjo është kështu sepse Allahu ka fuqi për çdo gjë, i lëviz zemrat ashtu siç kontrollon dhe trupat, dhe mund ta largojë atë nga disa gjëra të cilat ai është i vendosur si mëshirë për të, për t'i ruajtur besimin dhe fenë e tij, tregohet Bujar me të nga prej nuk ja pret mendja atij, Bujarinë e Tij kërkojmë në të gjitha çështjet dhe lehtësimin e tij për më të lehtë.

U pyetën disa: si e njohët Zotin tuaj (se ekziston)?

Thanë: sa herë kam qenë në rrezik dhe më ka shpëtuar, kam qenë sëmurë e luta dhe më shëroi, kam qenë i varfër dhe më pasuroi, kam qenë i humbur nga e vërteta dhe u tregua Bujar me mua dhe më udhëzoi, e kjo smë ka ndodhur vetëm mua, sa të mira si kjo e të tjera i bën robërve të Tij aq sa nuk ka kufi e nuk numërohet, e kjo më ka detyruar mua ta njoh se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe me bën të njoh Fuqinë dhe Mëshirën e Tij.

Iu është thënë disave: si e njohët Allahun (se ekziston)?

Thanë: kemi parë ne dhe të tjerë përveç nesh në këtë dunja vdekjen e tiranëve kriminelë dhe përfundimin e tyre të tmerrshëm, ashtu siç kemi parë ne dhe të tjerë të njëzëit e mirë vdekjen e tyre të mirë. Pra ia shpejtoi robërve një



shembull për shpërblimin dhe dënimin, që ta njohin atë, ti nënshtrohen vetëm Atij dhe ta adhurojnë vetëm Atë.

Iu tha dikujt tjetër: si e njohe Allahun (se ekziston)?

Tha: nga dërgimi i mirësive të Tij që iu çon krijesave në kohë nevoje dhe domosdoshmërie që kanë për to.

E shiun e zbret Allahu në kohë nevoje dhe e largon atë para se të behet i dëmshëm, edhe shpëtimi vjen kur vështirësohet situata edhe pikësynimet vijnë prej Tij atëherë kur është nevoja dhe këto gjymtyrë të njeriut dhe fuqinë e tij ia jep Allahu ato pak e nga pak sipas nevojës për to.

Pra a mund të jënë të gjitha këto çështje në mënyrë krejt të rastësishme?

Apo mësohet nga kjo me bindje të plotë se Ai që ia dha atyre ato në kohë nevoje dhe domosdoshmërie është Zoti i cili meriton të adhurohet Sunduesi i Gjithëlavdishmi?

Them: nga ky kapitull në të cilin flasim në lidhje me njohjen e Allahut, përderisa njohja për Allahun është më e madhe se të gjitha nevojat dhe domosdoshmëria për të i kalon të gjitha domosdoshmëritë, Allahu ia lehtësoi atë robërve të Tij dhe ia bëri të qartë e të kuptueshme rrugët e saj, i hapi atyre dyert dhe udhët e saj, i qartësoi argumentet e saj, e kjo për shkak të nevojës së madhe rreth saj dhe për shkak të Mëshirës së madhe të Allahut dhe Dashamirësisë së Tij.

Iu tha disa të tjerëve: si e njohët Allahun?



Thanë: ai njihet sepse Ai ja mëson njeriut atë që ai nuk e di, doli nga barku nënës dhe ai nuk dinte asgjë, ia dha mjetet e njohjes e ia lehtësoi atij shkaqet e saj dhe nuk ndalon së mësuari çështjet e fesë së tij derisa ai të bëhet dijetar edukator dhe nuk ndalon së mësuari çështjet e dunjasë derisa ai të bëhet mjeshtër shpikës i gjërave të habitshme dhe Ai ia lehtësoi atij çdo sebeb që ai ta arrijë këtë gradë.

Nga gjërat më të çuditshme është se tabela nëse shkruhet në të dhe përdoret për ndonjë gjë, nuk mund të përdoret për ndonjë gjë tjetër dhe nuk mund të shkruhet në të përpara se të fshihet ajo që u shkruajt më parë, ndërsa zemra e njeriut nuk pushon së memorizuari dhe përpunuari çështjet e njohuritë e llojeve të ndryshme.

Sa më shumë që të zgjerohen njohuritë e tij, sa më shumë shtohet dija e tij e aq më shumë forcohet kujtesa e tij. Pra a janë këto çështje në kapacitetin e njeriut dhe mundësitë e tij (që ti bëjë vetë nga hiçi) ?

Apo ky është nga argumentet më të mëdha e cila tregon për Madhësinë e Allahut, se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq dhe për Mëshirën e Tij të Gjërë!

Iu tha disa të tjerëve: si e njohët Allahun?

Thanë: këto bërthama të cilat i mbjellin njerëzit, vjen prej saj e bëhen palma dhe pemë të ndryshme dhe nxjerrin fruta të shijshme e të dobishme.

E këto fara të cilat i hedhin njerëzit në tokë, dalin prej tyre prodhime të ndryshme të cilat janë ushqimi i njerëzve dhe



kafshëve të tyre, pastaj kjo vazhdon dhe shtohet çdo vit aq sa i mjafton robërve dhe i tepron për nevojat e tyre. A nuk është kjo provë dhe argument për ekzistencën e Allahut dhe Fuqinë e Tij, për përkujdesjen e Tij ndaj robërve dhe për Mëshirën e Tij?! Me të vërtetë Allahu ka tërhequr vëmëndjen për këtë provë dhe argument logjik të dëshmohet në fjalën e Tij:

﴿فَالِقُ الْحَبِّ وَالنَّوَى﴾ [الأنعام: 95]

“Allahu është Ai i Cili bën që të çahet dhe të rritet fara e grurit dhe e frutave” [Surja El-Enam 95]

Dhe në fjalën e Tij:

﴿أَفَرَأَيْتُمْ مَا تَحْرُثُونَ ﴿٦٣﴾ أَأَنْتُمْ تَزْرَعُونَهُ أَمْ نَحْنُ الَّذِينَ نَزْرَعُونَ ﴿٦٤﴾﴾

[الواقعة: 63-64]

“A e shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj?” [Surja El-Uakiah 63-64]

I është thënë atij të cilit shpejtoi për të besuar tek i Dërguari i Allahut ﷺ çfarë të bëri të besosh?

Tha: e pashë se nuk urdhëronte për diçka vetëm se mendja thonte: mjerë sikur të mos e kishte urdhëruar atë... dhe nuk ndalonte rreth diçkaje vetëm se mendja thonte: Mjerë sikur ta kishte urdhëruar atë. Pra u argumentua me dritën e mendjes së tij dhe fuqinë e aftësisë për të kuptuar rreth sinqeritetit të të Dërguarit të Allahut ﷺ për gjithëpërfshirjen me të cilën ka ardhur për të përmisuar



dhe për të larguar të keqen dhe se kjo është në pajtim me mendjet e shëndosha.

I është thënë disa të diturve: si e njohët Allahun (se ekziston)?

Thanë: duke shijuar embëlsinë e zbatimit të urdhëresave të Allahut dhe gëlltitur shijen e keqe të kundërshtimit ndaj Tij.

Ky është argumentim intuitiv për këdo që i është dhënë sukses për këtë gjendje, e si rezultat i saj detyrohet robi për ta plotësuar besimin dhe për ta shtuar bindjen, sepse çdokush që gjen embëlsinë e besimit dhe të zbatimit të urdhëresave të Allahut, i cili ka shijuar embëlsinë e bindjes së plotë dhe e ka provuar dhimbjen e gjynaheve kur e ka mundur vetja e tij e cila është e prirur nga e keqja, atëherë kjo gjë e detyron ta njohë Allahun e se Ai është Një dhe i Vetëm, se vetëm Ai është i përsosur, se i gjithë Sundimi universal i takon Atij, se të gjithë adhurimin e meriton vetëm Ai.

Iu tha disa të tjerëve: si e njohët Allahun (se ekziston)?

Thanë: më rregullsinë e shkaqeve në një model të vetëm, pastaj transformimin e disa prej tyre duke ja ndaluar shkaqet, dhe duke u gjendur disa gjëra të tjera pa asnjë lloj shkak.

Kjo është e saktë, sepse Allahu i Lartësuar i ka bërë gjërat me shkaqe dhe shkaktar, si në Caktimin e Tij në Ligjin Universal, ashtu dhe në Sheriatin Islam, që të njihet nëpërmjet kësaj Urtësie e Tij e madhe, që të gjallërohen



ata që punojnë e të jenë aktivë në veprat e tyre të cilat Allahu i ka lidhur me shkaqe dhe i ka bërë ato sipas Ligjit të Tij Universal, e megjithatë i ka ndaluar disa shkaqe që prej tyre të lindin efekte të caktuara, si përshebull në mrekullitë e Profetëve të cilat kanë ndodhur jashtë normales dhe në kerametet e njerëzve të devotshëm.

Gjithashtu ekzistojnë shumë gjëra jashtë shkaqeve të zakonshme, siç ka ardhur në jetë Isa (Jezusi) nga një mama pa baba, ose Jahja nga dy prindër që si shembulli i tyre normalisht nuk lindin.

Dhe shumë gjëra të këtij lloji, në mënyrë që robërit e Tij ta dinë se Ai ka kontroll absolut dhe se Ai ashtu siç i ndryshon gjërat me shkaqet e tyre të njohura të cilat kanë lidhje me to, ashtu ndërhyt dhe i ndryshon ato në mënyrë të pazakontë.

E pra shumica e argumenteve të këtij lloji është prej mrekullive të profetëve dhe kerameteve të njerëzve të devotshëm, por mund të ndodhi dhe nga të tjerë, porse të gjitha janë argumente për Allahun se Ai është Një dhe i Vetëm, se vetëm Ai është i përsosur dhe pa të meta, se i gjithë Sundimi absolut i takon vetëm Atij, se të gjithë adhurimin më të vërtetë e meritojnë vetëm Ai.

Iu tha disa të tjerëve: si e njohët Allahun (se ekziston)?

Thanë: kush shikon në mjetet e jetesës dhe mediton në gjëndjen e atyre të cilët kanë në pronësi gjëra të shumta, prona dhe të ardhura të shumta porse ato u mbështeten tek ato, e kështu ju vështirësuan atyre çështjet dhe ju shtuan



borxhet e ju erdhën gjërat në të kundërt nga ajo që shpresonin.

Pastaj shiko në shumë njerëz të tjerë, s'kanë as prona e as të ardhura e as kanë në pronësi gjëra të tjera, porse atyre iu janë lehtësuar shkaqe të thjeshta për jetesë, aq sa nuk të shkon në mendje se atyre iu mjafton, porse Allahu i ka begatuar në to dhe ua ka lehtësuar atyre rrizkun dhe janë më zemërhapur i kanë shpirtrat më të qetë dhe jetesa e tyre është më e kënaqshme se atyre të parëve. Shkaku i kësaj është se ata i bënë sebeb duke ju mbështur Atij të cilit i kontrollon shkaqet, zemrat e tyre janë gjithmonë në pritje të asaj që është te Allahu, duke shpresuar prej tij lehtësimin e arritjes së rrizkut, ndërsa të parët janë në kundërshtim (me të dytët): zemrat e tyre janë të lidhura me pasuritë dhe ato çfarë posedojnë, e kështu njihet Allahu dhe mësohet se çdo gjë është nën kontrollin e Allahut.

Gjithashtu nëse shikojmë në gjendjen e shumë prej të fortëve, të zgjuarve të cilët punojnë natë e ditë e gjen se rrizku i tyre është i paktë dhe shkaqet që bëjnë janë të dështuara (për shkak se nuk i mbështeten Allahut), e nga ana tjetër gjejmë shumë nga dobëtit dhe të trashët, ata nuk kanë të njëjtën fuqi dhe zgjuarsia siç kishin të parët, porse Allahu jua ka lehtësuar atyre rrizkun dhe ua ka lehtësuar çështjet e tyre, e gjitha kjo është e dëshmuar dhe detyrohet i zgjuari ta dëshmojë se Allahu ka kontroll absolut dhe se të gjitha çështjet i ka nën kontroll Allahu.

Iu tha dikujt tjetër: si njihet se Allahu (ekziston)?



Tha: me ndërrimin e ditëve mes robërve me lavdi dhe me poshtërim, në pasuri dhe varfëri, me shkaqe dhe pa shkaqe.

Iu tha dikujt tjetër: si njihet Allahu?

Tha: duke vëzhguar atë që e vërteton thënien e Allahut të Lartësuar:

﴿وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا﴾ [هود: 6]

“Nuk ka krijesë të gjallë në tokë që të mos e ketë furnizimin e përshtatur nga Allahu” [Surja Hud 6]

Pra shihe se vlefshmëria e saj është gjithpërfshirëse për të gjithë krijesat, dhe se çdokujt ja ka lehtësuar Allahu mjetet e jetesës, dikujt nëpërmjet tregtisë, dikujt nëpërmjet prodhimit, dikush nëpërmjet bujqësisë, dikujt nëpërmjet punës dhe shërbimeve të tij, dikujt nëpërmjet trashëgimisë, dikujt nëpërmjet rritjes së kafshëve, dikujt tjetër nëpërmjet bamirësisë së të tjerëve, dikujt me lypje e dikujt pa lypje, dikujt nga puna e te tjerëve, e kështu me rradhë prej shkaqeve të mirënjohura të cilat i ka caktuar i Plotfuqishmi-më i Urti si furnizim për njerëzit, pra i Pastër dhe larg çdo mangësie është Ai i Cili ja çon rizkun milingonës më të vogël, dhe atij i cili ka nevojë në shkretëtirat më të largëta dhe ne thellësitë e deteve dhe të errësirave.



Iu është thënë disa të tjerëve: si njihet Allahu (se ekziston)?

Thanë: për ta njohur Allahun ka dyer dhe rrugë të shumta, prej saj është dhe ajo që ka udhëzuar Allahu robërit e tij në këto kohë, prej zbulimeve të shumta, elektriciteti, përçimi i zërave dhe dritave dhe të ngjashme me to në distanca dhe vende të largëta.

Ai e mësoi njeriun dhe Ai e aftësoi për këto gjëra, Ai i krijoi për atë lëndët dhe mineralet nga të cilat nxirren ato dhe e udhëzoi atë për ti ndërthurur ato.

Është e ditur se ai doli nga barku i nënës dhe nuk dinte asgjë, skishte mundësi për asgjë, e pastaj ia mësoi të gjitha këto gjëra, e të gjitha këto ishin pjesë nga bujaria e Allahut mbi të, pra krijuesi i shkakut është edhe krijuesi i pasojës, i Madhëruar dhe i Lartësuar është Ai.

Ky është argumenti më i madh për përsosmërinë e Fuqisë së Allahut i cili i dha aftësi robit të dobët për këto gjëra, të cilat më përpara llogariteshin nga gjërat e pamundura.

Them: të gjitha këto përgjigje rreth përgjithësisë dhe pjesëve të pjesshme janë të sakta, mendja është e detyruar ta njohi Zotin e saj dhe se Ai është Një dhe i Vetëm, dhe është e mundur (të sjellim argumente të tjera) shumëfish mbi këto.

Nëse ti shikon me një shikim të përgjithshëm në botën qiellore dhe atë tokësore dhe në madhësinë e këtyre krijesave, në rregullsinë e tyre të mahnitshme, në strukturën e tyre preçize dhe renditjen e tyre dhe çka



rezulton si produkt i saj për përfitime të botës dhe të krijesave, e kupton se kjo botë ka një Zot Madhështor, dhe një Sundues të Madh, i Plotfuqishëm për çdo gjë, e që Atij i është nënshtruar çdo gjë në ekzistencë, Atij i janë të përlurura të gjitha krijesat, Ai i ka nën kontroll të gjithë njerëzit, e pra prej kësaj e kupton se çdo gjë që është në qiej dhe në tokë është rob dhe skllav i Tij dhe ata asgjë s'kanë në dorë.

Pastaj nëse shikon çdo krijesë veç e veç dhe mediton çfarë krijimi të habitshëm që janë dhe çfarë urtësi të mahnitshme përmbajnë, e më pastaj të shohësh në mënyrë më të veçantë në veten tënde dhe në tiparet e tua, dhe çfarë është vendosur në të prej krijimit të habitshëm dhe urtësisë së mahnitshme, e mëson se Allahu është Zoti, Krijuesi, Furnizuesi, Ai që ka në kontroll çdo gjë, i Urtë për çdo gjë, ka thënë i Lartësuar:

﴿وَفِي الْأَرْضِ آيَاتٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ﴾ [الذاريات: 20]

“Dhe në tokë ka shenja për ata që kanë besim të palëkundur” [Surja Edh-Dharijat 20]

Të gjitha krijesat dhe çdo gjë që ndodh për shkak të Allahut janë prova dhe argumente se Ai është Një dhe Madhështor, një Zot Fisnik, dhe një Sundues Bujar.

Gjithashtu nëse mediton në Sheriatin e përsosur, se të gjitha lajmet e saj janë të vërteta, dhe të gjithë argumentet tregojnë për vërtetësinë e saj, se të gjitha dispozitat e saj janë të drejta, urdhëron vetëm për atë që është e mirë dhe



përmirësuese, ndalon nga e keqja dhe prishja, dispozitat e saj të përkryera dhe të drejtat e saj të cilat kanë vetëm me drejtësi ecin me kohën, sidoqë të ndryshojnë situatat, sidoqë të shkojnë zakonet nuk ikën vlefshmëria e saj dhe nuk zhvlerësohet udhëzimi i saj.

Madje nuk ka udhëzim e as përmirësim veçse me të, e nuk vjen me diçka të pamundur për mendjet dhe të tillë që ta përgenjeshetrojnë shqisat e sakta, porse mendjet e mençura dëshmojnë se dispozitat e saj janë dispozitat më të mira, më të drejta, më të sakta, më udhëzuese.

A nuk është ky argumenti më i madh për Madhështinë dhe Fuqinë e Allahut, për Dijen e Tij të gjërë, për gjithëpërfshirjen e Urtësisë dhe Mëshirës së Tij?

Dhe se Ai është i Lavdëruar në çdo kohë për krijimin e krijesave dhe zbritjen e sheriateve.

Çdo gjë që e ka krijuar, e ka krijuar në formën më të përkryer dhe çdo dispozitë e ka bërë me drejtësinë më të madhe, s'ka në to mangësi e as kotësi, e as diçka që shkon në kundërshtim në urtësinë në asnjë formë prej formave,

{صُنِعَ اللَّهُ الَّذِي أَتَقَنَ كُلَّ شَيْءٍ} [النمل: 88]

“Vepër e Allahut i Cili përsosi çdo gjë” [Surja En-Neml 88]

{وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ حُكْمًا لِقَوْمٍ يُوقِنُونَ} [المائدة: 50]



“E kush është më i mirë në gjykim se sa Allahu, për një popull që ka një Besim të fortë?” [Surja El-Maideh 50]

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “EKZISTENCA E ZOTIT ËSHTË MË E MADHJA SE ÇDO GJË”

Prej argumenteve më të mëdha se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe për obligueshmërinë e ekzistencës së Tij është edhe ajo çka kanë thërritur të Dërguarit popujt e tyre- lëvdatat e shumta dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi ta- ata ua tërhoqën vëmëndjen atyre për argumentet logjike rreth kësaj teme, dhe i lajmëruan ata hapur, të dakordësuar në të se: ekzistenca e Zotit është gjëja më dukshme se çdo gjë, më e kthjellëta, më e qarta dhe më e larta se çdo gjë dhe nuk mundet që të ketë në të fije dyshimi në asnjë aspekt prej aspekteve, e për këtë shkak të gjithë të dërguarit kanë thënë :

[أَفِي اللَّهِ شَكٌّ] [إبراهيم: 10]

“A ka dyshim për Allahun” [Surja Ibrahim 10]

Kjo është pyetje dhe mohim i madh për këdo që dyshon te Allahu dhe është sqarim se ajo është e rrënjosur në mendjet e krijesave dhe në natyrshmërinë e tyre se ekzistenca e Allahut dhe se Ai është i Vetëm e I Pashoq është gjëja më e dukshme dhe më e kthjellët dhe kush dyshon në këtë atëherë ai është kryelartë, mendjemadh i



cili nuk e vret mendjen për kundërshtimin e mendjes dhe të fesë.

Sepse çdo gjë, ekzistenca e tyre, vazhdimësia e tyre, ruajtja e tyre, arritja e gjërave plotësuese të nevojshme janë vetëm prej Allahut të Lartësuar, sepse Ai është i pari i cili skishte asgjë para tij dhe Ai krijoi çdo gjë, e për këtë shkak kanë thënë (profetët):

﴿أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ﴾ [إبراهيم: 10]

“A ka dyshim për Allahun Krijuesin e qiejve dhe të tokës” [Surja Ibrahim 10]

E pra Ai i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën, botën qiellore dhe tokësore me çdo gjë që gjendet në to, i solli ato në ekzistencë nga hiçi, i krijoi dhe e përsosi krijimin e tyre, nuk e mohon këtë vetëm se ai të cilit i ka shkarë mendja dhe ju janë përmbysur zemrat, të cilëve iu është prishur natyrshmëria dhe ju kanë çrregulluar mendimet e tyre. Shumica e armiqëve të dërguarve kanë qënë politeista të cilët e besonin ekzistencën e Zotit dhe se Ai është i veçuar në krijim, sikur ishte populli i Nuhut, i Hudit, i Salihut dhe të tjerëve, por ka pasur prej tyre edhe ateista sikur ka qënë faraoni, siç edhe ka thënë:

﴿وَمَا رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾ [الشعراء: 23]

“E çfarë është Zoti i gjithësisë” [Surja Esh-Shuara 23]

në formë mohuese,



﴿يَا أَيُّهَا الْمَلَأُ مَا عَلِمْتُ لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرِي﴾ [القصص: 38]

“O pari! Unë nuk di se ju keni ndonjë të adhuruar (Zot) tjetër veç meje” [El-Kasas 38]

Të gjithë të dërguarit i përkujtonin popujve të tyre përgënjeshtres dhe ju argumentonin atyre me krijimin e krijesave nga Zoti dhe se Ai është Zoti i botëve, Zoti i të parëve dhe të fundit, i kujtonin atyre mirësitë e shumta që iu kishte dhënë Allahu atyre dhe çdo i dërguar i thonte popullit të tij:

﴿أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِنْ إِلَهٍ غَيْرُهُ﴾ [الأعراف: 59]

“Adhuroni Allahun! Nuk keni Ilah (të adhuruar) tjetër veç Atij” [Surja El-Earaf 59]

Iu argumentonin atyre dhe iu tregonin prova atyre rreth kësaj se Ai është Krijuesi- Kontrolluesi i gjithçkaje, Dhënësi i të gjitha begative dhe se Ai i Cili cilësohet me të tilla Cilësi e ka me hak që adhurimi të jetë i sinqertë vetëm për të, të përmendet sa më shumë, të falenderohet sa më shumë, të lavdërohet sa më shumë.

Të gjitha këto janë argumente logjike nuk i mohon vetëm se ai që e ka flakur tutje mendjen dhe fenë.



PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: "SI KA VEPRUAR ALLAHU ME POPUJT PËRGJATË SHEKUJVE"

Gjithashtu ata i kanë kujtuar me ditët e mira e të këqija dhe ngjarjet që kanë pasuar në popujt zullumqarë, i kanë përmendur atyre se këto dënime janë fryt që ka ardhur nga kufri (mohimi) dhe se ato janë shembull i dënimit në botën tjetër.

Ato janë dënime dhe ndëshkime të cilat i kanë parë njerëzit me sytë e tyre dhe ata të cilët nuk i kanë parë ua kanë përcjellë popujt dhe brezat e mëparshëm, ku kanë ardhur lajmet e tyre brez mbas brezi.

E për këtë arsye e ka bërë Allahu këtë lloj argumentimi prej provave logjike shqisore, siç ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَسَكَنْتُمْ فِي مَسَلِكِ الَّذِينَ ظَلَمُوا أَنْفُسَهُمْ وَتَبَيَّنَ لَكُمْ كَيْفَ
فَعَلْنَا بِهِمْ وَضَرَبْنَا لَكُمْ الْأَمْثَالَ ۝﴾ [إبراهيم: 45]

“Dhe jetuat në vendbanimet e njerëzve që gabuan dhe i bënë keq vetvetes duke qenë e qartë për ju se si Ne u sollëm me ta; dhe Ne ju paraqitëm juve mjaft shembuj” [Ibrahim 45]

﴿أَوَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنْظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن
قَبْلِهِمْ﴾ [الروم: 9]



“A nuk udhëtojnë ata në tokë dhe të shohin cili qe përfundimi i atyre (popujve) para tyre!?” [Er-Rum 9]

﴿وَلَقَدْ أَهَلَكْنَا مَا حَوْلَكُمْ مِّنَ الْقُرَىٰ وَصَرَّفْنَا الْآيَاتِ لَعَلَّهُمْ

يَرْجِعُونَ ﴿٢٧﴾﴾ [الأحقاف: 27]

“Dhe me të vërtetë që Ne kemi shkatërruar qytete rreth e rrotull jush dhe Ne (vazhdimisht) u kemi treguar Ajetet (provat, dëshmitë) në forma të ndryshme, me qëllim që ata të mund të ktheheshin” [El-Ehkaf 27]

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “PAGABUESHMËRIA QË KANË PROFETËT DHE MREKULLITË E TYRE”

Gjithashtu ata i kujtuan atyre atë të cilën e posedojnë prej këshillës së përkryer, prej dijes së gjërë, sinqeritetit dhe se të gjithë të dërguarit janë njerëzit më të ditur-lavdërimet e shumta dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta- njerëzit me të sinqertë, njerëzit më këshillues për krijesat dhe se ata janë të ruajtur (nga Allahu) prej çdo cilësie të qortuar.

I përmendën atyre mrekullitë dhe argumentet e sinqeritetit të tyre gjë e cila i detyron robërit ta njohin se ata janë krijesat më këshilluese dhe se çdo gjë me të cilën ata kanë ardhur është e vërtetë.

Dhe më e madhja gjë në të cilën ata ftuar është: veçimi i Allahut në adhurim dhe njohja e Tij, pra të gjitha provat



dhe mrekullitë e profetëve, si dhe argumentet e sinqeritetit të tyre janë prej atyre provave që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe se Ai është i Vetmi Sunduesi i Vërtetë dhe i Qartë.

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “UNANIMITETI I FJALËS SË TË DËRGUIARVE RRETH TEUHIDIT⁴ TË ALLAHUT”

Pastaj të dërguarit-lavdërimet e shumta dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta- të cilët janë njerëzit më të lartë në çdo dije, në sinqeritet, në sqarim, në nderim, në plotësim, fjala e tyre është në unanimitet dhe është unifikuar thirrja e tyre në Teuhidin e Allahut dhe në adhurimin e Tij të vetëm i Cili s'ka ortak dhe për ta njohur obligueshmërinë ekzistencës së Allahut dhe përsosmërinë e Tij. Kjo është e verteta më e madhe dhe ajo është Teuhidi, krijesat më të mira (profetët) si nga ana mendjes, si nga ana fetare, si nga ana e vlerave janë në unanimitet rreth saj:

﴿تِلْكَ آيَاتُ اللَّهِ نَتْلُوهَا عَلَيْكَ بِالْحَقِّ فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَ اللَّهِ
وَأَعْيَاتِهِ يُؤْمِنُونَ﴾⁶ وَيَلِّ لِكُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ⁷ يَسْمَعُ آيَاتِ اللَّهِ تُتْلَى

⁴ Shënim I përkthyesit: Fjala “Teuhid” do të thotë: Veçimi i Allahut me adhurim, ose që çdo adhurim të bëhet vetëm për Allahun si dhe mos bësh idhujtari.



عَلَيْهِ ثُمَّ يُصِرُّ مُسْتَكْبِرًا كَأَن لَّمْ يَسْمَعْهَا فَبَشِّرْهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٨﴾

[الجاثية: 8-6]

“Këto janë Ajetet (provat, shenjat) e Allahut, të cilat Ne t’i rrëfejme me imtësi ty (O Muhammed) me të vërtetën. Atëherë, në çfarë fjale pas Allahut dhe Ajeteve të Tij do të besojnë ata? Mjerë për çdo gënjeshtar mëkatar, I cili i dëgjon Vargjet e Allahut të cilat i lexohen atij, e prapëseprapë këmbëngul me kryelartësi si të mos i kishte dëgjuar. Njoftoje pra atë me ndëshkim të dhimbshëm!” [Surja El-Xhathija 6 - 8]

PREJ ARGUMENTEVE (TË EKZISTENCËS SË ALLAHUT) ËSHTË: “DËSHMIA E ALLAHUT, E MELAIKEVE, E DIJETARËVE DHE E TË UDHËZUARVE”

(Gjithashtu prej argumenteve) është se Ai ka dëshmuar për Vetën e Tij- dhe dëshmia e Tij është më e madhja- se:

﴿شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَائِمًا بِالْقِسْطِ﴾

﴿لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ﴾ [آل عمران: 18]

“Allahu dëshmon se nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Atij; (e dëshmojnë) edhe melaiKET, edhe ata që kanë mend e që dinë; Ai e mban Krijimin e Tij në Drejtësi të plotë. Askush nuk ka të drejtë adhurohet përveç Atij, i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues” [Surja Aali Imran 18]



Të gjithë Melaiket dhe njerëzit e drejtë të dije, të cilët kanë si prijësa të tyre të dërguarit, pastaj dijetarët edukator, dhe të udhëzuarit, kanë dëshmuar për Allahun se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq e asnjëri prej tyre nuk ka kundërshtuar në këtë gjë.

Dhe se ai i cili pretendon se ka dije dhe nuk dëshmon për Allahun me këtë dëshmi, atëherë ajo me të vërtetë nuk është dije e dobishme, porse dije e dëmshme, ka ndikuar në zemrën e tij dukë lënë kryeneçësi dhe mëndjemadhësi dhe ajo është dija e trashëguar nga armiqtë e të dërguarve për të cilët Allahu ka thënë për ta:

﴿فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرِحُوا بِمَا عِنْدَهُمْ مِنَ الْعِلْمِ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ﴾ [غافر: 83]

“Ndërsa kur të Dërguarit e tyre erdhën tek ata me dëshmi të qarta, ata ishin të gëzuar nga ajo që ata njihnin nga dija (e gjërave të dunjasë) dhe ai (ndëshkimi) me të cilin ata u tallën, i rrethoi ata” [Surja Gafir 83]

Ka bërë me dije Allahu i Lartësuar se armiqtë e të dërguarve kanë dije me të cilat i kanë kundërvënë dijeve të të dërguarve, janë kënaqur me to dhe janë qetësuar rreth tyre e më pas janë tallur me çka u erdhën atyre të dërguarit, derisa iu zbriti dënimi gjithpërfshirës, turpërues dhe poshtërues.



Kjo është e njëjtë me refuzimin e ateistëve dhe materialistave kur iu erdhën atyre të dërguarit me Teuhid dhe me besim, e ata u tallën me ta dhe me ndjekësit e tyre (duke thënë) se ata janë të prapambetur dhe pasues të verbër, se ata janë pasues të çdo poterexhiu, se ata janë të prapambetur nga njerëzimi, e të ngjashme me këto me të cilat ulërasin mendjelehtët, të cilët kanë pasuar verbërisht ateistët në çdo gjë që ata thojnë dhe bëjnë, dhe janë mashtruar me njohuritë materialiste të kësaj dunjaje të cilat nuk i sjellin asnjë dobi atyre kur ato humbën shpirtin e fesë, madje dëmi i ktyre njohurive u bë më i madh tek ta se dobia e tyre, dhe e keqja e tyre më e madhe se e mira e tyre.

Dhe dëmi më i madh dhe e keqja më e madhe që i ndodhi atyre është se ata u bënë mendjemëdhenj kundrejt së vërtetës dhe kundrejt krijesave dhe i përbuzën dijet e të dërguarve dhe të pasuesve të tyre të cilat janë të dobishme e pastruese për zemrat dhe moralet, përmisuese për të gjitha çështjet, që sjellin çdo të mirë dhe udhëzim dhe larguese për të gjitha të këqiat.

Pra ata ateistë e ata të cilët i kanë ndjekur ata verbërisht, dijet e tyre kanë fryrë tek ta shpirtin e mendjemadhësisë dhe i kanë shndërruar ata në një nivel qe sështë në nivelin e tyre, e më pas i kanë parë robërit (sikur janë) më të këqinj se kafshët, ndërsa në realitet ata janë të nënçmuarit. Prej të këqiave të saj mbi ta është se edhe nëse përparon kultura dhe civilizimi i tyre porse ajo është kulturë dhe civilizim materialist i pastër, e kërcënuar në çdo kohë me zhdukje dhe shkatërrim.



Çfarë civilizimi dhe kulturë janë ato shpirti i së cilave është padrejtësia, babëzia, skllavërimi i të dobëve, përgatitja me armë të shkatërrimit në masë, asgjësuese për të mbjellat dhe bagëtitë, rezultati dhe frytet e së cilës janë lufta e egër mes njëri tjetrit, dhe goditja e njëri tjetrit me dënim të tmerrshëm. A nuk është ky argumenti më i madh për përsosjen e Fuqisë së Allahut, Drejtësisë dhe Urtësisë së Tij?

Këto çështje janë prej ditëve e ngjarjeve të tij dhe dënimit të ashpër mes njerëzve, dhe këto mësim dhe shembuj nuk u kanë shtuar atyre veçse kryeneçësi dhe largim.

E ata shkojnë nga një dënim i ashpër në një dënim më të ashpër, ata janë të verbuar në marrëzinë e tyre, dhe me civilizimin e tyre të neveritshëm e ata me gjurmët e saj mburren,

﴿يَعْلَمُونَ ظَهْرًا مِّنَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ عَنِ الْآخِرَةِ هُمْ غَافِلُونَ ﴿٧﴾﴾

[الروم: 7]

“Ata dinë vetëm pamjen e jashtme të jetës së kësaj bote dhe janë krejt të pavëmendshëm për fundin e punëve në Jetën e Përtejme” [Surja Er-Rum 7]

Sa mësim i madh është ajo sikur zemrat të kuptonin!

Sa treguese janë për Drejtësinë e Allahut, për Urtësinë e Tij, sikur kuptimet të ishin të sakta!

Porse zemrat janë mbuluar me mbulesën e shkujdesjes, të mendjemadhësisë dhe të mashtrimit, ndërsa shpirtrat kanë



rendur pas çështjeve të dëmshme, ia kanë marrë mendjen atyre pamjet vezulluese dhe i kanë magjepsur shikimin:

{أَفَمَنْ زُيِّنَ لَهُ سُوءُ عَمَلِهِ فَرَآهُ حَسَنًا} [فاطر: 8]

“A është ai, që veprat e veta të këqija i duken të mira (njësoj si ai që është i udhëzuar në rrugën e drejtë)?”
[Surja Fatir 8]

{فَلَوْلَا إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا تَضَرَّعُوا وَلَٰكِن قَسَتْ قُلُوبُهُمْ وَزَيَّنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٤٣﴾ فَلَمَّا نَسُوا مَا ذُكِّرُوا بِهِ فَتَحْنَا عَلَيْهِمُ أَبْوَابَ كُلِّ شَيْءٍ حَتَّىٰ إِذَا فَرِحُوا بِمَا أُوتُوا أَخَذْنَاهُمْ بَغْتَةً فَإِذَا هُمْ مُبْلِسُونَ ﴿٤٤﴾} [الأنعام: 43-44]

“Shejtani ua bëri atyre t’u duken të drejta veprat që punonin. Kështu, kur ata harruan (këshillën, ndëshkimin) atë me çka u këshilluan, Ne i morëm ata në ndëshkim dhe ç’të shohësh! Ata u zhytën në shkatërrim, në dështim e pikëllim” [Surja El-En'am 43 - 44]

Ndërsa dëshmia e Tij të Lartësuarit për Vetën e tij se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq, atëherë kjo është prezente në të gjitha librat të cilat i ka shpallur tek të dërguarit e Tij, dhe të gjithë të dërguarit e Tij e kanë shqiptuar diçka të tillë, e thirrja e tyre është në unanimitet rreth kësaj, i ndoqën ata tek kjo edhe pasuesit e tyre prej dijetarëve edukatorë dhe të udhëzuarit si dhe të gjitha kategoritë e njerëzve të dijës dhe të besimit.



Gjithashtu i ka sjellë deshmitë vetore dhe universale rreth kësaj:

{وَمِنْ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ} [فصلت: 37]

“Dhe nga shenjat e Tij janë nata dhe dita, edhe dielli dhe hëna” [Surja Fussilet 37]

Gjithashtu bota qiellore dhe bota tokësore janë argumente të qarta dhe argumente të prera për ekzistencën e Krijuesit të saj, Kontrolluesit të saj, Përsosësit të krijimit të saj, Shpikësit të saj me një krijim të mahnitshëm, me një sistem madhështor dhe me urtësitë të cilat kanë dështuar oratorët dhe elokuentët rreth shprehjes dhe përfshirjes së disa provave dhe argumenteve të saj.

PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “PËRFUNDIMI I MIRË PËR BESIMTARËT DHE PËRFUNDIMI I KEQ PËR JOBESIMTARËT”

Prej dëshmisë së të Lartësuarit për Vetën e Tij se Ai është Një e i Vetëm dhe se Ai është i veçuar me Madhështi dhe Përkryeshmëri është: ajo çka i ka përshpejtuar për profetët e tij e pasuesit e tyre prej provave dhe mrekullive, e fitores së madhe dhe kerameteve të llojllojshme dhe shpërblimeve të lavdishme, si dhe ajo çka përshpejtuar për armiqët e Tij prej shkatërrimit të veçantë dhe të përgjithshëm, prej ndëshkimit të rreptë dhe pasojave të tmerrshme.



Gjithashtu edhe çka ka lënë për profetët dhe të kulluarit e Tij prej gjuhës së singertë e lavdërimit të përgjithshëm të përhapur dhe dashurisë në zemrat e krijesave e ndërsa për armiqtë e tij zemërimin dhe poshtërimin, dhe mallkimin e vazhdueshëm.

Të gjitha këto janë prova sqaruese se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq si dhe janë prova për singëritetin e të dërguarve të Tij, siç ka thënë i Lartësuar:

﴿سَلَّمَ عَلَى نُوْحٍ فِي الْعَلَمِيْنَ﴾ [الصافات: 79]

“**Selam mbi Nuhun, ndër gjithë Alemin** (ndër njerëzimin, xhindet dhe gjithë çështë e çka krijuar Allahu)” [Surja Es-Safat 79]

﴿سَلَّمَ عَلَى إِبْرَاهِيْمَ﴾ [الصافات: 109]

“**Selam mbi Ibrahimin**” [Surja Es-Safat 109]

﴿سَلَّمَ عَلَى مُوسَى وَهَارُونَ﴾ إِنَّا كَذَلِكْ نَجْزِي الْمُحْسِنِيْنَ ﴿﴾

[الصافات: 120-121]

“**Selam mbi Musën dhe Harunin. Sigurisht që kësisoj i shpërblejmë Ne Muhsinunët** (mirëpunuesit në Rrugën e Allahut)” [Surja Es-Safat 120-121]

﴿ثُمَّ كَانَ عَاقِبَةَ الَّذِينَ أَسَّأُوا السُّوْأَىٰ أَنْ كَذَّبُوا بِآيَاتِ اللَّهِ وَكَانُوا بِهَا

يَسْتَهْزِءُونَ﴾ [الروم: 10]



“Pastaj i keq dhe i mjerë qe fundi i atyre që punuan të keqen e ligësinë, sepse ata përgënjeshtroan Ajetet e Allahut (provat, shenjat, shpalljet Tona) dhe u tallën me to” [Er-Rum 10]

PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “NJOFTIMI I ALLAHUT DHE I TË DËRGUARIT TË TIJ ﷺ RRETH ÇËSHTJEVE TË FSHEHTA”

Nga argumentet më të mëdha e përmbledhëse midis të qënurit universale dhe logjike perceptore, është edhe njoftimi që Allahu ka dhenë në Librin e Tij, në Sunnetin e të Dërguarit të Tij ﷺ rreth çështjeve të cilat janë të fshehta e ato janë të shumta, ndodhi të shkuara në kohën e shpalljes, çështje të tashme të cilat kanë ndodhur në ditët e përcjelljes së Mesazhit (hyjnor), si dhe çështje në të ardhmen të cilat akoma vazhdojnë të ndodhin pak e nga pak, tamam në përputhje me atë formë siç ka lajmëruar i Dërguari i Allahut ﷺ dhe ato janë të panumërta në llojin e tyre aq më tepër në të të veçantat e tyre, të cilat meritojnë që të bësh një shkrim të veçantë për to.

Gjithsecila nga to është argument, pastaj me të dytën, me të tretën, me të katërtën, e me atë që vjen pas saj janë argumente të shumëfishta, e të gjitha ato e detyrojnë vështruesin ta njohë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq si dhe ta njohë të dërguarin me mesazhin e tij dhe se të gjitha ato të cilat ka lajmëruar Allahu dhe ka lajmëruar i Dërguari janë të vërteta dhe pa pikën e dyshimit.



PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “SFIDA QË ALLAHU I KA BËRË TË GJITHË NJERËZVE DHE XHINËVE QË TË SJELLIN NJË SHEMBULL TË NGJASHËM ME KURANIN”

Prej kësaj është edhe sfida që Allahu i ka bërë të gjithë njerëzve dhe xhinëve që të vijnë me një shembull të ngjashëm si Kurani, si dhe lajmërimi që Ai i ka bërë se nuk kanë mundësi dhe as nuk kanë për të pasur që ata të vijnë me një shembull të ngjashëm me të, sfidë kjo që është e hapur në çdo kohë, por dështimi i krijesave është i dukshëm, me motivimin e armiqve në dispozicion, dhe me perkujdesin e tyre të madh për të kundërshtuar atë me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut ﷺ si dhe përfolet keq në mesazhin e tij.

Ky është argument i madh, nga i cili detyrohet çdo i logjikshëm i cili ka paanësi ta njohi të vërtetën me të cilën janë ngritur argumentet sqaruese e të qarta dhe provat e mahnitshme për vërtetësinë e tij nga çdo drejtim.

PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “EFEKTET E VYERA TË RREGULLUARA MIRË NË MESAZHIN E MUHAMEDIT ﷺ”

Prej argumenteve për (ekzistencën e Allahut) dhe se Ai është Një i Vetëm dhe i Pashoq si dhe prej argumenteve për vërtetësinë e asaj me të cilën ka ardhur Muhamedi ﷺ janë edhe efektet të cilat rrjedhin dhe janë rezultat i mesazhit të Muhamedit ﷺ. Ai u dërgua në një popull



analfabet, ku toka ishte e mbushur me injorancë, me politeizëm, me të këqija të mëdha, e më pas i udhëzoi Allahu prej humbjes, i mësoi ata pas injorancës, u përmirësuan moralet dhe veprat e tyre, e u mbush toka me mirësi, me udhëzim, me përmisim, si dhe u përhap mëshira, drejtësia dhe u realizua nëpërmjet saj shpëtimi dhe suksesi.

U hapën zemrat me dituri të dobishme, me njohuri të sakta dhe me besim, dhe e triumfoi Allahu fenë e Tij përmbi fetë e tjera, u përhap dhe e pranuan atë zemrat e qëndrueshme në çdo cep të botës dhe nëpërmjet saj u zhduk çdo e kotë dhe intrigë. Ithtarët e saj ishin triumfator mbi të tjerët për aq kohë sa ishin të kapur mbas saj, dhe i jepnin asaj hakun e vet, derisa u fut devijimi në çështjet e besimit dhe të moraleve tek ithtarët e saj, tek çështjet e fesë dhe dunjasë, e më pas i ikën atyre efektat e saj të vyera dhe u ndërruan me të kundërtat e saj.

A nuk është ky argumenti më i madh se këtë legjislacion e ka ligjësuar i Plotfuqishmi, më i Urti, dhe e ka ndihmuar atë Zoti i Madhërishëm?

Dhe se e mira nuk i ndahet asaj dhe e ndjek atë në mësimdhënien dhe në moralet e saj?

Dhe se ajo është shpallje e Më të Urtit, të Lavdishmit?

Dhe se lajmet e saj janë të gjitha të sakta, e dëshmojnë vërtetësinë e tyre mendjet e sakta?

Dhe nuk ka ardhur asnjë lajm i vetëm i saktë që të kundërshtojë realitetin dhe ndjenjat?



Me të vërtetë se ajo nuk ka ardhur me diçka të pamundur për mendjet, e mbase ka ardhur me diçka që huton mendjet dhe nuk udhëzon për tek ajo, sepse në legjislacionin Islam ka detaje madhështore lajmëruese dhe gjykuese aq sa nuk arrin mendja e intelektualëve dhe nuk udhëzohet tek ajo zgjuarsia e mëndjemprehtëve.

Nuk ka ardhur ndonje dituri e saktë apo teori e vërtetë e pranuar nga të gjithë intelektualët që të kundërshtojë atë me të cilën ka ardhur i dërguari Muhamed ﷺ, e a ka në argumentet bindëse argument më të madh sesa kjo dhe më të qartë sesa ky sqarim,

﴿وَتَمَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ صِدْقًا وَعَدْلًا لَا مُبَدَّلَ لِكَلِمَاتِهِ ۗ وَهُوَ السَّمِيعُ

الْعَلِيمُ ﴿١١٥﴾ [الأنعام: 115]

“Dhe fjala e Zotit tënd është plotësuar me vërtetësi dhe me drejtësi” [Surja El-En'am 115]

Me vërtetësi në lajmet e saj, me drejtësi në dispozitat dhe ligjet e saj.



PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “PREÇIZITETI I LEGJISLACIONIT ISLAM, VËRTETËSIA E LAJMEVE TË SAJ DHE KONSENSUSI I DISPOZITAVE TË SAJ”

Prej argumenteve që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm dhe i Pashoq, për sinqeritetin e të dërguarve të Tij dhe realitetin e asaj me të cilën kanë ardhur: është se Legjislacioni Islam është i përkryer në kulmin e përsosmërisë, lajmet e saj janë të konfirmuara, faktet e saj janë në përputhje, dispozitat e saj janë në harmoni të ndërsjelltë, njerëzimi nuk ka mundësi të sugjerojë sikur ajo në bukuri, pajtueshmërinë e saj për çdo kohë dhe vend, zbatueshmërinë e saj në çdo situatë, rrjedhshmërinë e saj në udhëzim, në rrugë të drejtë, qëndrueshmëri dhe në përmisim, në të ska as kundërshtim mes veti dhe as mospajtim, as kotësi, as mangësi, as çrregullim.

Sa më shumë thellohet në të dijetari largpamës e kupton se ajo është më e sinqerta për vërtetësinë e lajmeve, më e dobishmja për zemrat, se ajo ka dispozitat më të mira, më përmisuese në adhurime, në marrëdhëniet e saj dhe në detajimin e të drejtave të veçanta dhe të përgjithshme, siç ka thënë i Lartësuari:

﴿أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْفُرْعَانَ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِنْدِ غَيْرِ اللَّهِ لَوَجَدُوا فِيهِ

أَخْتِلَافًا كَثِيرًا﴾ [النساء: 82]

“A nuk mendojnë thellë për Kur’anin? Po të kishte qenë ai prej dikujt tjetër e jo prej Allahut, sigurisht që



do të kishin gjetur në të mjaft kundërthënie e mospërputhje” [Surja En-Nisa 82]

Pra i tërhoqi vëmendjen Allahu njerëzve me mend rreth këtij argumenti të madh, i cili është nga argumentet më të mëdha, më të qarta dhe më të vyera se ajo është nga Ai, dhe se ajo është e gjitha e vërtetë dhe se ajo që e kundërshton atë është e kotë, siç ka thënë i Lartësuari:

﴿وَيَرَى الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ الَّذِي أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقُّ وَيَهْدِي
إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ﴾ [سبأ: 6]

“Dhe ata të cilëve u është dhënë dija, shohin se ajo që të shpallet ty (O Muhammed) nga Zoti yt është e Vërteta dhe që udhëzon drejt Rrugës së të Gjithëmëshirshmit, Zotëruesit të të gjitha lavdërimeve” [Surja Sebe'e 6]

A nuk ka ardhur kjo fe me çdo të vërtetë dhe e kanë vërtetuar atë të sinqertët?

A nuk ka ndaluar nga gënjeshtria dhe i ka larguar gënjeshtarët?

A nuk ka nxitur për drejtësi të plotë në të drejtat e Allahut dhe të drejtat e robërve?

A nuk e ka ndaluar padrejtësinë, prishjen, gjithë të këqiat dhe shkatërrimin?



A nuk është ndërtuar në bazë të besimit, të sinqeritetit, Teuhidit dhe a nuk ka ndaluar për çdo gjë e cila e kundërshton këtë prej shirkut e politeizmit?

A nuk ka urdhëruar për sjellje të mirë me prindërit dhe mbajtje të lidhjeve farefisnore, për ti bërë mire fqinjëve e të varfërve, e për ti bërë mirë në përgjithësi gjithë krijesave, madje edhe bagëtive, e Ai ka lajmëruar se i do punëmirët?

A nuk ka urdhëruar për ti përmushur marrëveshjet, detyrimet, premtimet dhe betimet? E a nuk ka ndaluar nga tradhëtia, shkelja e fjalës dhe padrejtësia?

A nuk ka nxitur për ti bërë shkaqet e dobishme për dunjanë dhe botën tjetër?

Dhe a nuk ka urdhëruar që mos ti mbështetemi atyre por ti mbështetemi shkakhtarit të sebebeve dhe të shpresojmë nderimin e Zotit të botrave?

A nuk na ka lejuar neve gjërat e mira dhe a nuk na ka ndaluar neve çdo gjë që është e fëlliqur? E a nuk na ka nxitur ne për çdo gjë që është e dobishme dhe a nuk ka paralajmëruar për çdo gjë që është e dëmshme?

A nuk ka urdhëruar për të bërë durim ndaj gjërave të padëshiruara dhe a nuk na ka urdhëruar që të jemi falenderues tek gjërat e dashura dhe në hare?

A nuk na ka ndaluar prej frikës së madhe, padurimit, trembjes, dobësisë dhe moraleve të ulta?



A nuk ka nxitur rreth fuqisë, trimërisë, dëlirësisë, dhe rreth çdo morali të bukur?

A nuk ka urdhëruar për çdo të mirë si në legjislacion, si nga ana logjike, si nga ana natyrshmërisë?

Dhe a nuk na ka ndaluar nga çdo e keqe si në legjislacion, si nga ana logjike, si nga ana e natyrshmërisë?

Nuk ka urdhëruar për diçka vetëm se e kanë parë atë njerëzit e mendjeve të shëndosha se ajo është gjëja më e mirë dhe më e drejtë, dhe nuk ka ndaluar nga diçka vetëm se nga cilësitë më të shëmtuara dhe më të poshtra.

I ka sqaruar besimet e sakta e të dobishme pa të cilat zemrat nuk bëjnë dot, dhe i ka bërë të obligueshme e i ka bërë baza mbi të cilën ndërtohen fjala dhe veprat, çështjet e fesë dhe të dunjasë, e ka ardhur me moralet fisnike dhe punët e mira me të cilat përmisohen individët dhe shoqëritë, dhe më të cilat qëndrojnë saktë adhurimet dhe marrëdhëniet. Cilën të mirë, udhëzim, përmirësim të shpejtë a të vonuar, nuk e ka sqaruar dhe ka thërritur tek ajo? E cilën të keqe, shkatërrim, dëm të shpejtë a të vonuar, nuk ka paralajmëruar rreth rrugëve dhe shtigjeve të saj?

Cilën bazë prej bazave, cilën rregull prej rregullave, cilin lajm prej lajmeve të saj, e cilën dispozitë prej dispozitave të saj e kanë hedhur poshtë dituritë e sakta, apo e kanë kundërshtuar mendjet dhe sistemet e sakta?

Porse janë ngritur argumentet të cilat skanë kundërshtim, se çdo gjë e cila është ndërtuar mbi diçka tjetër atëherë ajo



është dëm dhe rrënues, dhe çdo “ndërtesë” e cila është ngritur jo sipas udhëzimeve dhe dispozitave të saj atëherë fundi i saj është rrënimi dhe shkatërrimi.

Dhe çdo sistem i cili është mbështetur tek diçka tjetër përveç saj përfundimi i saj është i keq, sepse Ai i Cili e ka ligjësuar është I Dituri i të fshehtave dhe i dëshmive, i Plotfuqishmi më i Urti, i Cili ka dijeni për çdo gjë, i Cili ka përfshirë çdo gjë me Mëshirën dhe Bujarinë e Tij, i Cili i ka garantuar sukses dhe begati çdokujt që vepron sipas tij dhe është i qëndrueshëm në të, dhe i ka premtuar shpërblimin dhe shpëtimin çdokujt që e adhuron Atë me të dhe i nënshtrohet Atij me të.

Ai është argumenti më i madh për Madhësitinë e Allahut, se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq, në Plotëfuqishmërinë e Tij, si dhe ai është argumenti më i madh i provave i cili tregon për Urtësinë e Tij, Lavdërimin, Dhuntinë dhe Bujarinë e Tij.

Ai është udhëzimi, mëshira, shërimi, drita, ai është drejtuesi e shpëtimi për të gjitha çështjet:

﴿الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الْأُمِّيَّ الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْتُوبًا عِنْدَهُمْ فِي التَّوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ يَأْمُرُهُمْ بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَاهُمْ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَائِثَ وَيَضَعُ عَنْهُمْ إِصْرَهُمْ وَالْأَغْلَالَ الَّتِي كَانَتْ عَلَيْهِمْ فَالَّذِينَ آمَنُوا بِهِ وَعَزَّرُوهُ وَنَصَرُوهُ وَاتَّبَعُوا النُّورَ الَّذِي أُنزِلَ مَعَهُ ۗ أُولَٰئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿١٥٧﴾﴾ [الأعراف: 157]



“Ata të cilët ndjekin të Dërguarin, Profetin që s’di as të shkruajë e as të lexojë të cilin e gjejnë të shkruar në Teurat dhe në Inxhil - ai i udhëzon ata për El-Ma’ruf (Besimin e Pastër Islam në një Zot dhe gjithë rregullat e detyrimet e tjera të tij); i ndalon ata nga El-Munker (mosbesimi, politeizmi i çdo lloji dhe gjithë ndalimet e tjera të Islamit); ai u lejon atyre si të ligjshme At-Tajibat (gjithçka të mirë dhe të ligjshme për besimin, punët, njerëzit, ushqimet, sendet) dhe ua ndalon si të paligjshme Al-Khabaith (gjithçka të keqe dhe të palejueshme për besimin, punët, njerëzit, ushqimet); ai i çliron ata nga barrët e rënda (të Marrëveshjes së Allahut me Bijtë e Israilit) dhe nga prangat që qenë mbita. Ata që e besojnë atë (Muhammedin), që e nderojnë atë, që e ndihmojnë atë dhe që ndjekin Dritën (Kur’anin) e zbritur me të, mu këta janë më të fituarit” [Surja El-Earaf 157]

﴿إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَايَ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ يَعِظُكُمْ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٩٠﴾﴾
[النحل: 90]

“Vërtet që Allahu urdhëron El-Adl (drejtësi në adhurim vetëm ndaj Allahut) dhe El-Ihsan (të punuarit mirë, durimin në përmbushjen e detyrave ndaj Allahut vetëm për Hir të Tij dhe sipas Sunnetit) dhe ndihmën e bujarinë ndaj gjakut e farefisit dhe Ai ndalon El-Fahsha (politeizmin, ligësitë, poshtërsitë, imoralitetin, etj) edhe



Munkerin (gjithçka që ndalon Islami) **edhe Beghin** (çdo lloj shtypje e padrejtësie). **Ai ju qorton dhe ju udhëzon që të mund të përkujtoni e të vëni mend”** [Surja En-Nehl 90]

﴿وَيَرَى الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ الَّذِي أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ هُوَ الْحَقُّ وَيَهْدِي إِلَى صِرَاطٍ الْعَزِيزِ الْحَمِيدِ﴾ [سبأ: 6]

“Dhe ata të cilëve u është dhënë dija, shohin se ajo që të shpallet ty (O Muhammed) nga Zoti yt është e vërteta dhe që udhëzon drejt Rrugës së të Gjithëmëshirshmit, Zotëruesit të të gjitha lavdërimeve” [Surja Sebe'e 6]

﴿وَتَمَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ صِدْقًا وَعَدْلًا لَا مُبَدَّلَ لِكَلِمَاتِهِ﴾ [الأنعام: 115]

“Dhe fjala e Zotit tënd është plotësuar me vërtetësi dhe me drejtësi” [Surja El-En'am 115]

Pra këtij Kurani e këtij legjislacioni i takojnë atributet më të plota e cilësitë më madhështore, dhe informuesi i saj në të gjitha burimet i shpjegon këto cilësi madhështore pa të cilat ska gëzim për krijesat vetëm se me mësimin, sjelljen e me udhëheqjen e dritave të saj dhe me realizimin e të vërtetave dhe sekreteve të saj.



Kapitulli



PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “SINQERITETI I TË DËRGUARVE DHE OBLIGIMI PËR TI RESPEKTUAR E PËR TI DHËNË PËRPARËSI FJALËS SË TYRE”

Prej argumenteve tregues se Ai është Një i Vetëm e i Pashoq, si dhe prej argumenteve tregues të Përsosmërisë dhe të veçuarit të Tij me Madhështi: është se ajo u ka vërtetuar me argumente dhe prova të ndryshme të cilat nuk numërohen as ato, as llojet e as të veçantat e tyre, është sinqeriteti i të dërguarve dhe se ato me të cilën ata erdhën është e vërtetë, në veçanti prijësi dhe zotëria i tyre Muhamedi ﷺ.

Obligohet mbi krijesat ta njohin pozitën e profetëve dhe se ata dallohen nga pjesa tjetër e llojeve të krijesave me të gjitha përshkrimet e nderuara, dhe se besimi tek to, dashuria, respekti dhe bindja ndaj tyre janë nga obligimet dhe detyrimet më të mëdha.

Dhe obligohet që në zemrat e njerëzve të jetë madhërimi dhe nënshtrimi me të cilën kanë ardhur dhe i cili zhduk çdo thënie (të kotë), dhe ska kundërshtim mes fjalëve të tyre dhe arsytimeve, apo analogjive apo me shijet, apo të tjera nga të cilat anojnë njerëzit e së kotës, madje nuk realizohet besimi i robit derisa ti bëjë fjalët e të dërguarve baza e bazave, dhe baza në të cilën ktheht tek ajo çdo gjë.



Është e ditur se thelbi i thirrjes së tyre dhe baza e saj është thirrja për në Teuhidin e Allahut dhe njohjes së Tij, për tek robërimi i Tij dhe sinqeritetin e veprës për Të, dhe argumentet për këtë janë sqaruar se nuk ka kundërshtim për sinqeritetin e tyre dhe saktësinë me të cilën kanë ardhur.

Obligohet mbi çdo rob i cili ka fe dhe logjikë të pranojë atë me të cilën kanë ardhur pa shtuar ndonjë kusht, sepse origjina është saktësia dhe baza është vërtetësia me një vërtetësi me bindje të plotë, ndërsa kundërshtimet janë të gjitha të kota, sepse çdo gjë që kundërshton të vërtetën është e kotë:

{فَمَاذَا بَعَدَ الْحَقِّ إِلَّا الضَّلَالُ فَأَنَّى تُصِرُّونَ} [يونس: 32]

“Kështu, pas së vërtetës, ç’gjë tjetër mund të ketë përveçse të gabuarës?” [Surja Junus 32]

Kush është i nënshtruar ndaj arsytetimeve të atyre të cilët e mbajnë veten për të ditur apo teorive të njerëzve të kotë, dhe i jep përparësi kundrejt asaj me të cilën kanë ardhur të dërguarit, atëherë e ka treguar qartë për mangësinë e mendjes së tij, madje humbjen e fesë së tij.

Kjo e gjitha edhe sikur të supozojmë se ka mundësi që të ketë çështje logjike që kundërshtojnë atë me të cilën kanë ardhur të dërguarit, e si është puna me arsyetimet e sakta të cilat e përforcojnë atë me të cilën kanë ardhur të dërguarit, e ajo është prej argumentave më të mëdha për sinqeritetin e tyre, porse kundërshtimi ndodh prej



arsyetimeve të disa njerëzve mendjelehtë, mëndjemëdhenj me njohuritë dhe mendimet e tyre të vogla, Allahut i kërkojmë ndihmë.

Ka thënë Shejhul Islam Ibn Tejmijeh:

Mrekullitë e profetëve janë prej atyre të cilat i dinë të logjikshmit se janë të veçanta për to, dhe jo nga ato që janë për të tjerët, pra e dinë se Allahu nuk ka krijuar si shembulli i tyre për të tjerët përveç profetëve, njësoj si në mrekullitë gjatë kohës që kanë qënë te popujt e tyre, dhe njësoj me mrekullitë të cilat Allahu ndau mes ithtarëve të tyre dhe përgenjshtruesve, duke i shpëtuar ata dhe duke i shkatërruar të tjerët.

Si shembulli i përmbytjes që Allahu i bëri të gjithë njerëzve në tokë përveç Nuhut dhe atij të cilit hipi me të në anije, kjo ska ndodhur absolutisht në botë sikur ky rast. Gjithashtu shkatërrimi i popullit të Adit, “Banorë të Iremit me pallate shumëshyllëshe, të atillë që nuk janë krijuar askund tjetër në tokë si ata”

Mëgjithëse ata ishin të shumtë në numër, të fortë dhe me ndërtesa të mëdhaja të pa ndërtuara ndonjëherë në ndonjë vend, u shkatërruan nga një erë e fortë e vrullshme, e cila u dërgua për ta shtatë netë dhe tetë ditë, derisa u bënë si trungje hurmash të hedhura, e shpëtoi Hudi dhe ata që e pasuan, e si ky rast ska ndodhur absolutisht kurrë në botë.



Gjithashtu populli i Salihut banues nëpër qytete dhe me vendbanime nëpër fusha, male, kopshte, u shkatërruan që të gjithë nëpërmjet një ulërimë të vetme, e si ky rast absolutisht ska ndodhur kurrë në botë.

Gjithashtu populli i Lutit banues të shumë qyteteve, u ngritën në qiell e pastaj u përmbysën, dhe u ndoqën me gurë nga qielli që shkonin tek homoseksualët e tyre, dhe shpëtoi Luti dhe familja e tij përveç gruas së tij, i ndodhi asaj ajo që i ndodhi dhe atyre, si ky rast absolutisht ska ndodhur kurrë në botë.

Gjithashtu populli i Faraonit dhe i Musës, dy grupe të mëdha që i ndau deti, çdo anë e detit ishte si mal masiv, ecën ata (populli i Musës përmes detit) dhe dolën shëndoshë e mirë, ndërsa kur ecën ata të tjerët ju kthye uji (dhe u mbytën), e si ky rast absolutisht ska ndodhur kurrë në botë.

Këto mrekulli i njohin të gjithë të logjikshmit se ata s'janë nga lloji i cili vdes biri i Ademit, mund t'i ndodhë disave murtaja e disave lebrosa e kështu me rradhë, kjo është nga ajo që janë mësuar njerëzit e nga ana tjetër ajo është provë nga Allahu, madje çdo ndodhi është prej mrekullive të Allahut, porse këto mrekulli s'janë nga lloji të cilat janë mësuar njerëzit.

Gjithashtu Qabja e cila është e ndërtuar nga gura në një luginë të pakultivuar askush nuk kishte kush ta ruante nga armiku, nuk kishte as kopshte në të cilat dëshirojnë njerëzit, pra nuk ekzistonte tek ajo as dëshirë (për të shkuar) dhe as kërcënim, e megjithatë ja ruajti asaj



prestigjin dhe madhështinë, çdokush që vjen për tek ajo vjen i përulur i nënshtruar në kulm, e ka vënë tek ajo dëshirën që të vijë njerëzit nga ana të ndryshme të botës, dashuri dhe përmallim pa ndonjë interes të dunjasë, e ajo është në këtë gjëndje prej mijra vitesh, kjo nuk njihet për ndonjë ndërtesë tjetër në botë, gjë e cila i ka vënë në vështirësi filozofët dhe ato si shembulli i tyre.

Gjithashtu çfarë bëri Allahu me njerëzit e elefantit kur ata synuan prishjen e saj, e synuan atë një ushtri e madhe të cilët me vete kishin elefantë, e kështu vendalitetë ikën prej saj (prej Qabes për të shpëtuar), ndërsa elefantët u gjuhëzuan dhe nuk drejtoheshin kah saj, ndërsa kur i kthenin në drejtime të tjera ato drejtoheshin, pastaj iu erdhën atyre nga deti zogjtë Ababil, domethënë në grupe të ndara, grup pas grupi, i gjuajtën ato me gurë derisa i shkatërruan të gjithë, si ky rast absolutisht ska ndodhur kurrë në botë, pra mrekullitë e profetëve janë prova dhe argumente për sinqeritetin e tyre. Prej kësaj është edhe ligji universal i Allahut në ndarjen mes profetëve e ithtarëve të tyre dhe mes përgënjeshtresve.

Pastaj përmendi mrekullitë në shkatërrimin e përgënjeshtresve dhe shpëtimin e të dërguarve, duke thënë:

"Këto lajme kanë qënë të shpërndara dhe të transmetuara brez pa brezi nëpër botë, dhe njerëzit e kanë marrë vesh se ato ishin mrekulli për të dërguarit dhe dënim për përgënjeshtresit, kështu ato i përmendin si shembuj për të marrë mësim, ndërsa mrekullia e Kuranit është e



pranishme përgjatë gjithë kohës, qëkur erdhi i dërguari (Muhamed) lexohen ajetet e sfidimit për të dhe lexohet fjala e Allahut:

﴿قُلْ لَّيْنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْحِجْنُ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ ۚ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا﴾ [الإسراء: 88]

“Thuaj: “Nëse njerëzimi dhe xhindet do të mblihdeshin të gjithë bashkë për të nxjerrur ngjasimin e këtij Kur’ani, ata nuk do ta bënin dot as përngjasimin e tij” [Surja El-Isra 88]

I Dërguari lajmëroi që prej fillimit për këtë, duke qenë i sigurt rreth saj, e duke qenë se ai e dinte sa shumë krijesa ka, e kjo tregon që ishte diçka e jashtëzakonshme nga e cila lloji i njeriut dhe i xhinëve ishin të paafte për kundërshtimin e saj, kjo gjë nuk ndodh tjetër përveçse me profetët, pastaj me kalimin e kohëve atë e ka dëgjuar ai që pajtohet dhe ai që kundërshton, arabët dhe jo-arabët, s’ka asnjë që të ketë dalë tek popujt dhe të ketë nxjerrë një libër që të lexohet nga njerëzit dhe të thotë se ai është sikur Kurani.

Këtë e di çdokush, nuk ka fjalë që të kenë folur njerëzit edhe nëse ajo është në gradën më të lartë të fjalës dhe kuptimit, vetëm se e kanë thënë njerëzit të ngjashmen e saj dhe atë që i afrohet, njësoj sikur të ketë qënë poezi apo ligjërim, apo fjalë në dituri, apo në urtësi apo në argumentim, apo në këshillim, apo në mesazhe, e të tjera



si kjo, nuk është gjendur diçka si kjo veçse është gjendur dhe diçka e ngjashme me të apo që i afrohet asaj.

Ndërsa për Kuranin e dinë të gjithë njerëzit arabët dhe jo-arabët se s'ka të ngjashëm me të, megjithë kujdesin e madh të arabëve dhe jo-arabëve për ta kundërshtuar.

Pra fjala e saj është argument, formulimi i saj është argument, lajmërimi i saj për çështjet e së fshehtës është mrekulli, urdhërimi dhe ndalimi i saj është mrekulli, këshillimi i saj është mrekulli, lavdia, madhështia, pushteti që ka në zemra është mrekulli, nëse përkthehet në gjuhë tjetër nga ajo arabe kuptimet e saj janë mrekulli, e gjitha kjo nuk ka të ngjashëm në botë”...

e deri në fund të asaj që ka thënë ai Allahu e mëshiroftë.



Kapitulli



PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “SE AJO ME ÇFARË ERDHËN TË DËRGUARIT ËSHTË E VËRTETA DOBISHME, DHE ÇFARË E KUNDËRSHTON ATË ËSHTË E KOTË”

Prej argumenteve logjike që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe për sinqeritetin e të dërguarve është se: të gjithë të dërguarit e në veçanti prijësi dhe vula e tyre Muhamedi ﷺ kanë ardhur me të vërtetën e dobishme, lajmet e tyre janë të gjitha të vërteta dhe të sinqerta, dispozitat e tyre janë të gjitha me hak, të drejta dhe me urtësi, nuk ka diçka që të jetë e vërtetë vetëm se kanë ardhur me të, e kanë sqaruar atë dhe kanë nxitur krijesat për tek ajo dhe ska asnjë të kotë vetëm se e kanë qartësuar atë dhe i kanë paralajmëruar krijesat prej saj.

Për këtë bazë janë në pajtim të gjithë njohësit e profecive me një njohje të saktë, e kush pretendon nga ana logjike se e kundërshton këtë bazë me të cilën kanë ardhur të dërguarit atëherë merret vesh me bindje se logjika e tij është e prishur dhe pretendimi i tij është i kotë, sepse mendja e saktë nuk e kundërshton të vërtetën e saktë.

Prej asaj që e qartëson këtë dhe e përforcon: se e vërteta me të cilën kanë ardhur të dërguarit qoftë lajm apo dispozitë, është e vërtetë e qartë e ditur dhe e pagabueshme, nuk ndahet në të lavdërueshëm dhe të



qortueshëm, porse e gjitha ajo është e vërtetë e lavdërueshme, ndërsa ajo çfarë pretendojnë kundërshtarët e të dërguarve prej arsyetimeve, atëherë ato mbështeten në arsyetime të cilat ndahen në të vërtetë dhe në të kotë, e lavdërueshme dhe e qortueshme me pajtimin e të gjithë njerëzve të logjikshmëm, e ndjekësit e saj janë në një kundërshtim të madh, çdo grup ka logjika të cilat mbështesin dhe qortojnë logjikat e të tjerëve, e ato janë në qorrsoak, mosmarrëveshje dhe në një kundërshtim të çrregullt siç ka thënë i Lartësuari:

﴿بَلْ كَذَّبُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ فَهُمْ فِي أَمْرٍ مَّرِيحٍ﴾ [ق: 5]

“Por ata e kanë mohuar të vërtetën (Kur’anin), kur ai u ka ardhur atyre, kështu që ata janë në gjendje hutimi” [Surja Kaf 5]

A është ndjekja e atyre të humburve, injorantëve, të pështjelluarve më parësore se ndjekja e të dërguarve të Allahut të cilët janë krijesat më të ditura, krijesat më të udhëzuara, krijesat më të sinqerta, krijesat më të mira, më të lartit e tyre në çdo cilësi dhe plotësim?

Ato janë larg çdo mangësie, larg çdo të mete e shkarje dhe janë të ruajtur nga të rënurit në gabim në fjalët dhe veprat e tyre, si dhe u janë shpallur atyre librat e mëdhenj prej Zotit Madhështor, (libra të cilat) janë lënda e udhëzimit dhe burimi i mëshirës, mirësisë, rrugës së drejtë, dritës, baza e kënaqësisë dhe e shpëtimit.



Allahu i ka bërë të ndryshme llojet e argumentimit për sinqeritetin e tyre, dhe saktësinë e asaj me të cilën kanë arritur, dhe se ajo është e vërteta e çdo gjë tjetër përveç saj është e kotë, e ajo është dritë, mëshirë, mirësi dhe të tjerat përveç saj janë errësirë, të këqija dhe shkatërrim,

﴿فَبِأَيِّ حَدِيثٍ بَعْدَ اللَّهِ وَآيَاتِهِ يُؤْمِنُونَ﴾ وَيَلُّ لِكُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ ﴿٧﴾
يَسْمَعُ آيَاتِ اللَّهِ تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ثُمَّ يُصِرُّ مُسْتَكْبِرًا كَأَن لَّمْ يَسْمَعْهَا
فَبَشِّرْهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٨﴾ [الجاثية: ٦ - ٨]

“Këto janë Ajetet (provat, shenjat) e Allahut, të cilat Ne t’i rrëfjmë me imtësi ty (O Muhammed) me të vërtetën. Atëherë, në çfarë fjale pas Allahut dhe Ajeteve të Tij do të besojnë ata? Mjerë për çdo gënjeshtar mëkatar, I cili i dëgjon Vargjet e Allahut të cilat i lexohen atij, e prapëseprapë këmbëngul me kryelartësi si të mos i kishte dëgjuar. Njoftoje pra atë me ndëshkim të dhimbshëm!” [El-Xhathijeh 6-8]

Uallahi janë qartësuar rrugët për ata që do kalojnë, janë shfaqur argumentet e së vërtetës dhe provat e saj për të bindurit, është qartësuar udhëzimi dhe drita e bindjes për të logjikshmit, dhe argumenti iu është ngritur kryeneçëve.

Të gjithë mjeranët kundërshtuesit e të dërguarve kanë qënë që e dinin se kanë kundërshtuar të dërguarit dhe logjikën, dhe kanë thënë:



﴿وَقَالُوا لَوْ كُنَّا نَسْمَعُ أَوْ نَعْقِلُ مَا كُنَّا فِي أَصْحَابِ السَّعِيرِ ﴿١٠﴾﴾

فَاعْتَرَفُوا بِذَنبِهِمْ فَسُحْقًا لِأَصْحَابِ السَّعِيرِ ﴿١١﴾ [المالك: ١٠، ١١].

“Dhe do të thonë: “Veç sikur të kishim dëgjuar ose të kishim menduar, ne nuk do të kishim qenë mes banorëve të Zjarrit flakërues!” Pastaj ata do të dëshmojnë mëkatin e tyre. Kështu pra, larg prej banorëve të Zjarrit flakërues!” [Surja El-Mulk 10-11]

PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË:

“NATYRSHMËRIA E PASTËR NË ZEMRAT E ROBËRVE, NË VEÇANTI PROFETËT”

Prej argumentave logjikë që tregojnë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq si dhe panevojshmërinë e Tij për krijesat dhe nevojën e madhe që kanë krijesat për Të është edhe:

Natyrshtëria që i ka dhënë Allahu robërve të Tij, në veçanti të veçantët e krijesave, prej profetëve dhe të dërguarve, prijësit e udhëzimit dhe pishtarët e errësirës, njerëzit me mendje të shëndosha dhe me mendime të pjekura, të cilët janë shtresa më e lartë e krijesave.

Ato janë krijuar me natyrshërinë për njohjen e plotë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq dhe se Ai është qëllimi i adhurimit në të gjitha situatat, kjo çështje në zemrat e tyre është e vërteta më e madhe, më e qarta dhe më vyera, e ato janë dituri shumë të qarta të domosdoshme të cilat askush nuk mund ti injorojë.



Ai që e mohon këtë nuk ka me çka ta injorohë këtë dije të saktë dhe këtë rrugë argumentuese, vetëm nëqoftëse mungon dija e tij për këtë, për shkak të prishjes së kuptimit të tij, angazhimit me besime të kota dhe moskokëçarjes së tij për të kërkuar udhëzimin. Ajo që është e ditur me dakordësinë e të gjithë të logjikshmëve se mungesa e dijes nuk konsiderohet si dyshim aspak, aq më tepër që të jetë argument i cili shmang argumentin më të fortë, më të vyerin, më të sinqertin prej të diturve, prej të bindurve vendosmërisht, ata të cilët janë krijesat më të mëdhaja në dije, të cilët kanë bindjen më të madhe, më të sinqertët, më mendjekthjellët, e me gjuhët më të pastra. Kjo bindje në zemrat e atyre të cilët janë udhëheqësit e të parëve dhe të fundit, nuk barazohet dhe i afrohet asgjë, prandaj të dërguarit i kanë thënë popujve të tyre:

﴿أَفِي اللَّهِ شَكٌّ﴾ [إبراهيم: 10]

“A ka dyshim për Allahun” [Surja Ibrahim 10]

Gjithashtu thotë i Lartësuari:

﴿قَبَائِي حَدِيثٍ بَعْدَ اللَّهِ وَعَائِيَتِهِ ۖ يُؤْمِنُونَ ﴿٦﴾ وَيَلِّ لِكُلِّ أَفَّاكٍ أَثِيمٍ ﴿٧﴾
يَسْمَعُ آيَاتِ اللَّهِ تُثَلَّى عَلَيْهِ ثُمَّ يُصِرُّ مُسْتَكْبِرًا كَأَن لَّمْ يَسْمَعْهَا
فَبَشِّرْهُ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٨﴾﴾ [الجاثية: ٦-٨]

“Këto janë Ajetet (provat, shenjat) e Allahut, të cilat Ne t’i rrëfejme me imtësi ty (O Muhammed) me të vërtetën. Atëherë, në çfarë fjale pas Allahut dhe Ajeteve të Tij do të besojnë ata? Mjerë për çdo



gënjeshtar mëkatar, I cili i dëgjon Vargjet e Allahut të cilat i lexohen atij, e prapëseprapë këmbëngul me kryelartësi si të mos i kishte dëgjuar. Njoftoje pra atë me ndëshkim të dhimbshëm!” [Surja El-Xhathijeh 6-8]

Pra kjo dije bindëse e qartë e domosdoshme e cila është në unanimitet nga njerëzit e dijes dhe të bindjes, më e madhja e krijesave në çdo cilësi të plotë, e ajo është dija më e plotë tek ata, më e qarta, më e vyera, dhe që në origjinë është e pamundur ti afrohet ndonjë dije më ndonjë të vërtetë bindëse, e kush dyshon në të ose është i pavendosur atëherë ka treguar për veten e tij se ka injorancë, humbje dhe mëndjelehtësi, e ajo është mëndjemadhësi e qartë, Allahu është dhënësi i suksesit.

PREJ ARGUMENTEVE ËSHTË: “UNANIMITETI I MUSLIMANËVE DHE AI I CILI E NJEH GJËNDJEN E TË DËRGUARIT ﷺ”

Prej argumentave më të mëdha se e vërteta është ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari Muhamed ﷺ në të gjitha të vërtetat e sakta e të dobishme është unanimiteti mes të gjithë muslimanëve dhe prej të gjithë atyre që e kanë njohur gjëndjen e Profetit ﷺ se ai është në mënyrë kategorike krijesa më e ditur për Allahun dhe me të vërtetat e dobishme, sqaruesi më i madh, qartësuesi më i mirë, oratori dhe këshilluesi më i mirë për krijesat.

Këto çështje nëse plotësohen-e ato janë të plotësuar- në formën më të plotë tek Muhamedi ﷺ në atë formë që mos



t'i afrohet askush atij në dije, oratori dhe këshillë, atëherë mësohet me bindje të domosdoshme se çdo gjë me të cilën ai ka ardhur është e vërtetë në të cilën ska dyshim në të.

Aq më tepër në Teuhid, dhe sqarimi i tij madhështor se Allahu ka Emrat dhe Cilësitë më të përsosura e të larta, me të cilat është veçuar me to, e asnjë s'e ka ortakëruar në to, kjo pra e vetme është argument i qartë e i mjaftueshëm për këdo që ka pak logjikë, ose që vë veshin e dëgjon me vëmëndje e është dëshmues.

Sa habi me atë që kundërshton këtë profet të madh, i cili ka ardhur me një kushtetutë nuk ka parë bota më të madh, më të plotë dhe më të saktë se ajo, (e kundërshton atë duke marrë) fjalët e materialistëve të cilët janë mëndjelehtë dhe i kanë mendjet e prishura, e u qartësua se të gjitha fetë që kundërshtojnë janë injorancë, humbje, mëndjemadhësi e qartë, kjo është e njohur nëse i ndjek të gjitha çështjet të cilat ato kanë kundërshtuar të dërguarit.

Ka thënë i Lartësuarit për ta dhe ata si shembulli i tyre:

﴿فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرِحُوا بِمَا عِنْدَهُمْ مِنَ الْعِلْمِ وَحَاقَ

بِهِمْ مَا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٨٣﴾ [غافر: 83]

“Ndërsa kur të Dërguarit e tyre erdhën tek ata me dëshmi të qarta, ata ishin të gëzuar nga ajo që ata njihnin nga dija (e gjërave të dunjasë) dhe ai (ndëshkimi) me të cilin ata u tallën, i rrethoi ata” [Surja El-Gafir 83]



Përfundimi është se:

Çdo qenie, çdo gjë që ndodh, çdo gjë që njihet, çdo lëvizje është provë e argument se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq, është provë për Zotin e tokës dhe të qiejve,

Kush i solli krijesat nga hiçi?

Kush i kontrollon dhe sistemon çështjet?

Kush i ka krijuar qiejt dhe tokën, e i ka ruajtur ato me fuqinë e tij dhe i ka mbajtur ato në vendet e tyre?

Kush e ka krijuar njeriun nga një pikë sperme e ai bëhet kundërshtar i hapur?

Kush e jep jetën, vdekjen, lumturinë, trishtimin?

Kush i ka shkatërruar popujt zullumqarë me dënime të llojllojshme, e i ka shpëtuar të dërguarit me ndjekësit e tyre?

Në këto ka mësim dhe argumente të qarta.

Kush e ka krijuar farën e grurit dhe të frutave dhe ka bërë që nga toka të dalin lumenj dhe burime?

A nuk është kjo nga gjurmët e atij që i thotë diçkaje: “Bëhu!” dhe ajo bëhet?

Kush i ka dhënë çdo krijese atë që i përshtatet asaj, pastaj e ka udhëzuar çdo krijesë për tek gjërat e dobishme të cilës nuk i bëjnë dobi të tjerat përveç saj?



Kush i ka mësuar (njeriut) dituritë e ndryshme dhe disiplinat?

Kush e ka nxjerrë frutin e njomë nga dega e thatë?

Kush e ka bërë çdo gjë me saktësi maksimale, me sistem ekzakt dhe i ka përsosur ato?

Kush është Ai që e ka bërë çdo gjë pa gabime dhe ka ligjësuar kushtetuta e i ka bërë ato në kulmin e udhëzimit dhe të përmirësimit e i ka përsosur ato?

Kush i ka bërë retë e mëdha të mbushura me ujë që të lagin vendet dhe njerëzit?

A nuk është Ai, i Cili e rikthen krijimin pas vdekjes së tyre në Ditën e Ringjalljes dhe thirrjes së përbashkët?

Sa habi për atë që mohon Zotin dhe ringjalljen, s'ka më të humbur dhe më të verbër se ai!

Si nuk e pranon këtë çështje e cila është çështja më e madhe, më e qarta dhe më e vyera?!

Zot Madhështor i Cili vazhdon të jetë i tillë, Sundues i madh sundimi i të Cilit nuk mbaron, i ka përfshirë të gjitha botët me Mëshirën, dhe me Rizkun e Tij, nuk ka lënë as grimcën më të vogël e ta ketë harruar atë!

Dëgjon rënkimin e të sëmurëve dhe i përgjigjet lutjes së lutësve dhe i dhuron faljen dhe mëshirën e Tij atyre që pendohen.

Të lusim ty o Allah me Emrat dhe Cilësitë e Tua të larta të na furnizosh me besim të plotë dhe me bindje të



sinqertë, të na bëjnë dobi ne shenjat e Tua të cilat janë të dëgjuara, shenjat e Tua të cilat janë të dëshmuara, shenjat e Tua në univers dhe ato vetore, sepse ato janë argumente për ato që besojnë me bindje dhe shenja për të diturit, argumente për kryeneçët e mëndjemëdhenjtë, mëshirë prej Teje dhe bujari për të gjithë krijesat.

O Allah dërgo salauate dhe bekoje Muhamedin, familjen e tij, shokët e tij dhe ndjekësit e tij deri në Ditën e Gjykimit, na fal ne dhe prindërit tanë e të gjithë muslimanët, të gjallët prej tyre dhe të vdekurit, Amin.

E diktoi këtë i varfëri për Allahun Abdurrahman bin Nasir bin Seadij, Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët.



PËRMBAJTJA

Qëllimi i kësaj broshure.....	1
Krijimi i gjërave ka 3 kategori logjike.....	3
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Të menduarit në krijimin e njeriut dhe universeve.....	5
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Mëshira e përgjithshme e Allahut.....	9
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Të vrojtuarit në gjëndjet e ndryshme të hallexhinjve.....	11
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Përgjigja e Allahut ndaj lutjeve në cdo kohë.....	14
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Argumentet që kanë sjellë profetët.....	15
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Librat qiellorë dhe Sunneti profetik e çka përmbajnë ato prej normave dhe ligjeve	16
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Natyra e pastër e njeriut.....	18
Prej argumenteve të ekzistencës së Allahut: Shpërblimi i shpejtë për punëmirët dhe dënimi i shpejtë për punëkëqinjët	19
Rrugët për njohjen e Allahut janë të gjëra dhe të pakufizuara.....	22



Disa shembuj dhe histori për argumentimin rreth Allahut.....	23
Prej argumenteve është: Ekzistenca e Zotit është më e madhja se çdo gjë.....	36
Prej argumenteve është: Si ka vepruar Allahu me popujt përgjatë shekujve.....	39
Prej argumenteve është: Pagabueshmëria që kanë profetët dhe mrekullitë e tyre.....	40
Prej argumenteve është: Unanimiteti i fjalës së të dërguarve rreth Teuhidit të Allahut.....	41
Prej argumenteve është: Dëshmia e Allahut, e melaikeve, e dijetarëve dhe e të udhëzuarve.....	42
Prej argumenteve është: Përfundimi i mirë për besimtarët dhe përfundimi i keq për jobesimtarët.....	47
Prej argumenteve është: Njoftimi i Allahut dhe i të Dërguarit të tij sal-lallahu alejhi ue selem rreth çështjeve të fshehta.....	49
Prej argumenteve është: Sfida që Allahu i ka bërë të gjithë njerëzve dhe xhinëve që të sjellin një shembull të ngjashëm me Kurandin.....	50
Prej argumenteve është: Efektet e vyera të rregulluara mirë në mesazhin e Muhamedit sal-laAllahu alejhi ue selem.....	50



Prej argumenteve është: Preçiziteti i legjislacionit Islam, vërtetësia e lajmeve të saj dhe konsensusi i dispozitave të saj.....	53
Prej argumenteve është: Sinqeriteti i të dërguarve dhe obligimi për ti respektuar dhe për ti dhënë përparësi fjalës së tyre.....	60
Fjalë nga Shejhul Islam Ibn Tejmijeh.....	62
Prej argumenteve është: Se ajo me çfarë erdhën të dërguarit është e vërteta dobishme, dhe çfarë e kundërshton atë është e kote.....	67
Prej argumenteve është: Natyrshmëria e pastër në zemrat e robërve, në veçanti profetët.....	70
Prej argumenteve është: Unanimiteti i muslimanëve dhe ai i cili e njeh gjëndjen e të dërguarit sal-laAllahu alejhi ue selem.....	72